




RAPORT

“STUDIMI I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR PËR HARTËN

ZONALE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS”

Dhjetor, 2021

Vendimi

Komuna e Malishevës për përgatitjen e Raportit: "Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Malishevës 2021-2029" me numër identifikues: 62500-21-6000-2-3-6 dhe numër të arkivit përgatitur në Malishevë ka lidhur kontratë me "OZON Space SH.P. K" me datë: 01.10.2021

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Malishevës

Përgatitja e Raportit: "Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Malishevës është hartuar nga kompania "OZON Space SH.P. K" Prishtinë.

Drejtor ekzekutiv: Diellza ZEKA

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	4
1.1 QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR VSM-SË	7
1.2 PËRFITIMET NGA VSM-ja.....	9
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VSM PËR HZK.....	11
2.1. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MJEDISORE	12
3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së.....	15
4. FAZAT KYQE TË PROCESIT TË VNM-SË.....	16
5. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E MALISHEVËS.....	21
5.1 Historiku i Komunës së Malishevës.....	21
5.2 Pozita gjeografike dhe ndarja fizike.....	22
5.3 Topografia	23
5.4 Klima.....	23
5.5 Hidrografia	24
5.6 Rrjeti ekologjik.....	25
5.7 Demografia	25
5.8 Zhvillimi Ekonomik	26
5.9 Turizmi.....	26
5.10 Bujqësia.....	28
5.11 Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore	29
6. GJENDJA E MJEDISIT	32
7. IDENTIFIKIMI I VEPRIMEVE STRATEGJIKE NË MJEDIS	42
7.1 ZONA BUJQËSORE.....	44
7.2 ZONA PYJORE	50
7.3 ZONË BANIMI.....	55
7.4 ZONA EKONOMIKE INDUSTRIALE DHE ZONA KOMERCIALE	59
7.5 ZONA TURISTIKE & REKREATIVE.....	63
7.6 ZONA E MINIERAVE SIPËRFAQËSORE	69
7.7 SIPËRFAQET E UJORE DHE ZONAT E MBROJTURA SANITARE UJORE.....	71
7.8 ZONA E SHËRBIMEVE	75
7.9 ZONA E RRJETIT TË TRANSPORTIT	76

7.10 ZONAT E MBROJTURA.....	79
8. ZONAT MBISHTRESORE.....	84
9. MASAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT BAZUAR NË NDIKIMIN E HARTËS ZONALE	87
PËRFUNDIM	92
LITERATURA.....	94

1. Hyrje

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është instrument kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen. VSM i nënshtrohet hartimit të gjithë planeve dhe programeve për bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë, industrinë minerare, transportin, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin, turizmin, planeve kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural, përfshirë dhe mbrojtjen e peizazhit, të përdorimit të tokës, të cilat vendosin për miratimin e projekteve. Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si “një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendimmarrjes”.

Raporti i vlerësimit strategjik mjedisor (VSM) është përgatitur si dokument përfundimtarë i procesit të VSM-së, për Hartat Zonale komunale të Komunës së Malishevës.

Raporti është përgatitur sipas kërkesave të kornizës ligjore mjedisore të Kosovës, veçanërisht VSM është në përputhje me ligjin për VSM Nr. 03/L-230, i cili është në përputhshmëri me direktiven e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis”. Bazuar në legjislacionin përkatës në nivel kombëtarë, evropian dhe ndërkombëtarë, VSM ka për qëllim integrimin e çështjeve mjedisore në zhvillimin e planeve, programeve dhe politikave. Vlerësimi strategjik mjedisor është obligim ligjor por edhe funksional në të cilin analizohen ndikimet në mjedis në fushën e shfrytëzimit të tokës, bujqësisë, pylltarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionit, turizmit dhe fushave tjera.

Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-së është në përputhje me ligjin për VSM dhe rekomandimet e veçanta nga udhëzuesi për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Harta Zonale të komunave.

Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në Komunën e Malishevës, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin e planeve dhe programeve sipas hartës zonale të komunës, ndikimet e mundshme në mjedis si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis. Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre

ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për evitimin apo minimizimin e ndikimeve të Hartave Zonale në mjedis janë komponentët kryesore të këtij raporti. Për hartimin e këtij raporti janë përdorë të dhëna nga Plani Zhvillimor Komunal, Vlerësimi Strategjik Mjedisor për PZHK, raporte mjedisore nga Ministria e Mjedisit si Raporti për gjendjen e ajrit, si dhe të dhëna dhe materiale relevante të ngjashme. Gjithashtu janë realizuar vizita takime me zyrtaret komunal nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Synimet e VSM janë:

- Të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore,
- Zhvillimi territorit, të ruajë balancat e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e tokave bujqësore potenciale,
- Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik
- Mbrojtjen e territorit, trashëgimisë natyrore e kulturore, biodiversitetit dhe peizazhit.

Raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore, siq janë:

- ✓ Toka,
- ✓ Uji,
- ✓ Ajri,
- ✓ Faktorët klimatik,
- ✓ Mjedisi Natyror,
- ✓ Mbetjet,
- ✓ Zhurma,
- ✓ Popullsia dhe asetet materiale,
- ✓ Trashëgimia Kulturore,
- ✓ Peisazhi

Hartimi i raportit "Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor" për Komunën e Malishevës përfshinë pikat e mëposhtme:

- Një përmbledhje të informacionit bazë për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.
- Përshkrim të vizionit, të prioritetëve dhe objektivave kryesore të Hartave Zonale Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të.
- Përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet
- Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka mundësi të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani.
- Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin.
- Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel lokal ose kombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit .
- Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.
- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i hartave zonale.
- Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

1.1 QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR VSM-SË

Qëllimi i VSM-së mund të përkufizohet si garantimi që konsideratat mjedisore informojnë dhe integrohen në vendim-marrjen strategjike në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm nga këndvështrimi mjedisor. Më konkretisht, procesi i VSM-së mbështet autoritetet përgjegjëse për planet dhe programet, si dhe vendim-marrësit, që të marrin në konsideratë:

- Tendencat kyç mjedisore, potencialet dhe shqetësimet që mund të prekin apo mund të preken nga plani apo program
- Mjedisin urban, përdorimin e tokës, biodiversitetit, florës, faunës, cilësisë së ajrit dhe ujit sipërfaqësor e nëntokësor, hotspoteve të ndotjes, zonave me ndjeshmëri mjedisore, zonave të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore; zonave të përmbytura, ndotja, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe ujërave të zeza, shpërhapja urbane, urbanizimi i tokave potenciale bujqësore, degradimi i tokës, zhurmat,
- Infrastrukturën dhe shërbimet – sigurimi i ujit, transportit dhe reduktimi i shkarkimeve; menaxhimi i mbetjeve urbane të ngurta dhe të lëngshme; transporti alternativ;
- Ndikimet mjedisore të veprimtarive ekonomike dhe shoqërore si bujqësia, turizmi, industria dhe ndryshimet e parashikuara gjatë hartimit të planit
- Mjedisin dhe trashëgiminë historike e kulturore, aspektet dhe vlerat peizazhistike, qendrat historike etj;
- Mbrojtjen e burimeve natyrore, zonave të mbrojtura, tokave potenciale bujqësore.
- Masat për të shmangur, zvogëluar apo zbutur efektet negative dhe ato për të rritur e përforcuar efektet pozitive;
- Pikëpamje, sugjerime dhe informacion nga autoritetet përkatese, publiku dhe – sipas rastit – vendet fqinje që preken nga zbatimi i planit apo programit. Në përgjithësi, VSM-ja aplikohet për plane rregulluese territoriale, programe, politika dhe dokumente të tjerë me natyrë strategjike (përfshirë mundësisht edhe dokumentet ligjore).

VSM si një qasje e të menduarit strategjik, ka tri objektiva shumë konkrete:

1. Inkurajon integrimin e mjedisit dhe qëndrueshmërisë (duke përfshirë komponentën biofizik, sociale, institucionale dhe aspektet ekonomike), vendosjen e kushteve që mundësojnë një kornizë të propozimeve të ardhshme të zhvillimit;

2. Është një vlerë e shtuar në procesin e vendimmarrjes, që mundëson për të diskutuar mundësitë dhe rreziqet e opsioneve të zhvillimit dhe duke i kthyer problemet në mundësi;
3. Ndryshon mënyrën e të menduarit dhe krijon një kulturë strategjike në vendimmarrje, promovimin e bashkëpunimit institucional dhe dialogut, duke shmangur konfliktet e mundshme.

Pra, VSM ka për qëllim të garantoj konsiderimin dhe integrimin e aspekteve mjedisore që në fazat e para të planifikimit e deri në atë vendimmarrjes. Koncepti i VSM e ka origjinën nga planet rajonale të zhvillimit dhe përdorimit të tokës dhe resurseve natyrore. Në terma të përgjithshme planet dhe programet për të cilat kërkohet kryerja e VSM janë qëllime strategjike dhe vizionare.

1.2 PËRFITIMET NGA VSM-ja

Përfitimet kryesore që arrihen nga zbatimi i VSM-së janë:

- Promovon vendimmarrjen e integruar mjedisore dhe pjesëmarrjen e publikut në hartimin e politikave mjedisore.
- Forcon rolin e autoriteteve mjedisore përmes pjesëmarrjes së tyre.
- Përmirëson bashkëpunimin midis autoritetet të ndryshme (planifikimi, mjedisit dhe shëndetit).
- Proces bashkëpunimi mes shkencëtarëve dhe vendimmarrësve.
- Mundëson qasjen e shumë palëve të interesuara nëpërmjet konsultimit publik.
- E rritë transparencës në vendimmarrje, për shkak të përfshirjes së të gjitha niveleve të shoqërisë.
- Lehtëson projektimin e planeve dhe programeve të qëndrueshme mjedisore dhe bënë monitorimin e efekteve të tyre.
- Ofron për shqyrtimin e një gamë më të gjerë të alternativave, krahasuar me mundësitë që ofrohen në kuadër të një projekti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- Merr në konsideratë efektet kumulative, ndryshimet globale dhe alternativat në fazën e hershme të zhvillimeve.
- Forcon dhe riorganizon projektet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duke identifikuar paraprakisht ndikimet e mundshme, kërkesat për informata dhe duke reduktuar kohën dhe përpjekje për konsultime.
- Përmirëson qeverisjen e mirë dhe besimit tek publiku.
- Më pak masa zbutëse për shkak të përfshirjes së hershme të konsideratave mjedisore në plane dhe programe.
- Kontribuon për përmirësimin e përputhshmërisë me kërkesat e fushave tjera specifike të politikave mjedisore.
- Lehtëson fondeve të bashkë-financimit nga BE.
- Krijimi i një mjedisi të pastër pa mbeturina – menaxhimi i mbeturinave.
- Të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,

- Të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të neojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private,
- Të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
- Të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin.

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VSM PËR HZK

Përveç, Ligjit Nr. 03/L-230 të Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor janë konsultuar edhe ligjet tjera relevante mjedisore dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e këtij raporti:

- Ligji nr. 03/l-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji nr. 03/L-106 për Planifikim Hapësinor
- Ligji nr. 04/l-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji nr. 03/l–233 mbi Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji nr. 02/l-26 për Tokën Bujqësore
- Ligji nr. 02/l-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike
- Ligji nr. 02 / l-102 për Mbrojtjen nga Zhurma
- Ligji nr. 03/l-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
- Ligji nr. 03/l-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji nr. 03/l-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji nr. 04 / l-060 për Mbeturina
- Ligji nr. 02/l-197 për Kimikate
- Ligji nr. 02/l-78 për Shëndetësi Publike
- Ligji nr. 03/l-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës
- Ligji nr. 02/l-53 për Gjuetinë
- Ligji nr. 04/ l-176 për Turizmin
- Ligji nr. 04/-l-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
- Ligji nr. 03/l-163 për Minierat dhe Mineralet
- Ligji 2003/11 për Rrugët
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale
- Ligji nr. 03/l-104 për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare
- Ligji 2008/03-L039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, etj.

2.1. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MJEDISORE

Gjatë hartimit të këtij raporti për Hartat Zonale të Komunë së Malishevës disa nga konventat mjedisore të cilat janë marrë parasysh janë renditur me poshtë:

- Konventa e Bernës; “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”
- Konventa e Bazelit; “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”.
- Konventa e Vjenës; “Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit” dhe Protokollin e Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.
- Konventa e Aarhus-it;
- Konventa e Espoo-s “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar”.
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike,
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin,
- Konventa për ruajtjen e Florës dhe Faunës së egër të mjedisit natyror të Europës
- Konventa për mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të egra
- Konventa për Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha
- Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar
- Konventa për Rivlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar
- Konventa e Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare
- Konventa e Mbetjeve të Rrezikshme dhe asgjësimin e tyre,
- Konventa e Stokholmit; “Mbi dotësit organike të qëndrueshëm”,

Me theks të veçantë gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë në shqyrtim Konventa Aarhus, Espoo dhe Protokollin e Kievit.

Konventa Aarhus - Kjo konventë është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Aarhus) në Konferencën e Katërt Ministre si pjesë e procesit “Mjedisi për Evropën”. Kjo konventë vendos një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Nga palët në këtë konventë kërkohej t’i hartoj në dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive.

Konventa Aarhus-it parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin- Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- Të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipër përmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.

Konventa Espoo:

Konventa Espoo përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Po ashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve.

Protokolli i Kievit:

Është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, me që do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokolli është aprovua në një takim të jashtëzakonshëm të palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësim i Strategjik i Mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (VNM) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm.

Protokolli poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit.

- Protokolli kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillimi rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Protokolli lejon identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve të mundshme mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes duke zhvilluar politika të qëndrueshme të transportit se sa minimizimin e ndikimeve mjedisore në ndërtimin e rrugëve.
- Protokolli i Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, kërkon nga palët e tij që të vlerësojnë pasojat e planeve dhe programeve të tyre zyrtare. Protokolli i Kievit ofron një pjesëmarrje të gjerë të publikut në vendimmarrjen e qeverisë në sektorët zhvillimorë. Protokolli i Kievit rëndësi të veçantë i kushton edhe shëndetit njerëzor.

3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

Qëllimi i raportit të VSM-së për Hartën Zonale Komunale të Malishevës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë si pasojë e zbatimit të Hartës Zonale Komunale, si edhe të jap zgjidhje më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së do të përfshihen edhe propozimet e masave për parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative nga zhvillimi i Hartës Zonale Komunale të propozuar. Metodologjia për hartimin e raportit të VSM është në përputhje me ligjin e Kosovës për VSM-së Nr. 03/L-230, i cili është transpozim i direktivës së BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis”.

Duke u bazuar nga më sipër, raporti i VSM-së do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor të zones së Malishevës;
- Përshkrimi i qëllimit, prioritetëve dhe objektivave kryesore të Hartës Zonale Komunale;
- Përshkrimi i gjendjes momentale e mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk implementohet ky plan;
- Përshkrimi i karakteristikave mjedisore të zonave që ka mundësi të ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga plani;
- Përshkrimi i problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me Harten Zonale Komunale;
- Përshkrimi i objektivave dhe synimeve për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;
- Përshkrimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
- Përshkrimi i masave të parashikuara për të parandaluar ose zvogeluar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i Hartës Zonale Komunale.
- Një përmbledhje për përzgjedhjen e masave alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

4. FAZAT KYQE TË PROCESIT TË VNM-SË

Fazat:

Shqyrtimi

Gjatë shqyrtimit identifikohet nevoja për VSM që zbatohet në një plan, program apo projekt specifik. Shqyrtimi si proces fokuson burimet tek ato plane, programe apo projekte të cilat mund të shkaktojnë efekt të konsiderueshme në mjedis dhe shëndet dhe përjashton nga procesi i VSM-së ato të cilat kanë ndikime të vogla ose nuk kanë fare ndikime.

Studimi i shtrirjes/ qëllimit të VSM

Cështjet e identikuara gjatë studimit të shtrirjes/ qëllimit të VSM-së do të orientojnë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM-ja merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjëra mjedisore apo sociale, sic janë adaptimet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë për punësim etj. Qëllimi i kësaj faze është të përcaktohen cështjet kyqe që duhen adresuar në raportin e VSM-së.

Analiza e gjendjes ekzistuese

Analiza e gjendjes ekzistuese do të përbëjë bazën për vlerësimin e ndikimeve në mjedis dhe përpilimin e skemës së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme që të përvijohen tendencat e mundshme në të ardhmen – kështuqë duhet të bëhet analiza e tendencave në të kaluarën, me qëllim që të parashikohen zhvillimet që do të ndodhin në të. Vlerësimi i ndikimeve të pritshme nuk mund të bëhet pa kuptuar mirë gjendjen ekzistuese të cështjeve kyq të identifikuar në studimin e shtrirjes/ qëllimit të VSM-së.

Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse

VSM-ja analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. Një nga përfitimet kryesore prej VSM-së është se ai mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të një numëri projektesh të përfshira në dokumentin strategjik dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme akumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve të vogla individualisht, por të konsiderueshme të marra së bashku, që do të kryhen për një periudhë të caktuar kohore. Në vijim të rreziqeve dhe ndikimeve të

identifikuara, VSM-ja sugjeron masa zbutëse për të adresuar efektet e pritshme negative si dhe për të rritur ndikimet pozitive që do të vijnë nga zbatimi i planeve, programeve apo projekteve përkatëse. Kjo fazë ka për qëllim të vlerësojë efektet e konsiderueshme negative dhe pozitive të planeve përkatëse dhe në vijim të konkluzioneve të analizës së ndikimeve, të marrë në konsideratë alternativa dhe opsione dhe të formulojë masat zbutëse për të parandaluar, reduktuar dhe sa më shumë të jetë e mundur të kompensojë cdo ndikim të konsiderueshëm negativ të planeve, programeve apo projekteve përkatëse.

Hartimi i Raportit të VSM-së


Raporti i VSM-së përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë procesit të VSM-së dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është pregaditja e një raporti të shkruar mirë dhe të kuptueshëm, i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në një mënyrë të qartë dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit.

Adoptimi

Jepet informacion mbi adoptimin e planit, programit apo projektit përkatës, si janë reflektuar komentet dhe sugjerimet e procesit të konsultimeve si dhe për metodat e monitorimit të efekteve të konsiderueshme mjedisore që vijnë nga zbatimi i planit, programit apo projektit përkatës.

Monitorimi

Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për cdo efekt mjedisore të konsiderueshëm të paparashikuar.



Plani Zhvillimor Komunal, Plani Hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis kanë përcaktuar vizionin për mjedisin i cili përkufizohet si: Zhvillimi i qëndrueshëm i vendit duke mbrojtur pasuritë natyrore duke promovuar vlerat natyrore dhe duke mbrojtur ato nga ndotja dhe dëmtimi.

Fushat me theks të veçantë për trajtim në këtë raport janë:

- Trajtimi i ajrit të ndotur;
- Trajtimi i ujërave të ndotura;

- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i vend-depozitimeve sipas standardeve të BE-së;
- Mbyllja në zonat e ndryshme të vend-depozitimeve ekzistuese;
- Rehabilitimi i tokave të ndotura dhe burimeve të ndotjes;

Plani Zhvillimor Komunal i Malishevës paraqet një plan të hapësirës së Malishevës për vitin 2019-2027 si dhe janë trajtuar edhe gjatë hartimit të Hartave Zonale. Mbi bazën e programit të Qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, ajo përcakton edhe qëllimet të cilat në mënyrë të përmblendhur janë:

- Përmbytja e standardeve të kërkuara (BE, Organizata Botërore e Shëndetësisë - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbeturinat urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës;
- Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese apo substanca të cilat shkatërrojnë shtresën e ozonit, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;
- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona evropiane dhe ndërkombëtare;
- Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe
- Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve. Pothuajse të gjitha këto probleme mjedisore për të cilat Plani ka përcaktuar synimet, janë probleme me të cilat ndeshet edhe komuna e Malishevës.

Për një vlerësim sa më real të gjendjes mjedisore në komunën e Malishevës dhe luhatjen e saj në vite, krahas të dhënave për problematiken mjedisore të Komunës, informacione më të gjëra dhe

sistematike të ndotjes së ajrit, ujit ,tokës, zhurmave, menaxhimit të mbetjeve etj, u gjeten në Raportet Planit Zhvillimor Komunal, VSM për PZHK dhe dokumenta e raporte tjera të nivelit qendrorë, të përgatitura nga institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

5. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E MALISHEVËS

Të dhënat për këtë kapitull janë bazuar në të dhënat e marra nga dokumentet siq janë: Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027, pastaj nga materiale të tjera nga AMMK (Raporte për gjendjen e mjedisit, Zonat e Mbrojtura 2016, etj) dhe raporte të tjera, këto dhe raporte të tjera gjenden të cekura gjithashtu tek kapitulli-Literatura.

5.1 Historiku i Komunës së Malishevës

Territori i komunës së Malishevës ndryshe njihet edhe si Llapushë. Malisheva është një komunë e re e konsistuar pas vitit 1999 por vjetërsia e kësaj komune dëshmohet përmes gjetjeve arkeologjike, në mënyrë specifike prania e Tumave Ilire (tombstone) në qendër të Malishevës janë dëshmi se ky territor ishte një vendbanim i hershëm ilir bashkë me vendbanimet e tjera brenda komunës dhe më gjerë, të shtrira përgjatë lumit Mirusha. Historikisht qendra politike administrative ka ndryshuar në aspektin e emërimit dhe në aspektin e selisë qendrore. Në periudhën osmane është përmendur një vend i quajtur Bajraku i Astrazubit që shtrihej deri në vijën hekurudhore të Murës në veri e deri në Mrasor në perëndim. Më vonë hasim në emrin e qarkut të Rahovecit, që përfshin të njëjtin territor. Pas Luftës së Dytë Botërore, qeverisja lokale fillimisht u organizua në fshatrat Banjë dhe Kijevë, për t'u transferuar, në vitin 1960 në Malishevë. Në këtë mënyrë për herë të parë Malisheva u bë një qendër politiko-administrative. Në vitin 1965 Komuna e Malishevës ishte shpërbërë nga autoritetet jugosllave të asaj kohe. Për herë të dytë komuna e Malishevës u formua si qendër komunale në vitin 1986 për të vazhduar deri në vitin 1991, kur ajo u shpërbë përsëri nga qeveria serbe.¹

¹ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

5.2 Pozita gjeografike dhe ndarja fizike

Komuna e Malishevës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, përkatësisht në pjesën lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Territori i komunës përfshinë një sipërfaqe prej 306.48 Km² (2.8% të territorit të Kosovës). Kjo komunë kufizohet me komunat e Drenasit, Lipjanit, Suharekës, Rahovecit dhe Klinës. Qendra komunale e Malishevës, si njësi administrative territoriale, përbëhet nga 39 zona kadastrale dhe 44 vendbanime, përfshirë këtu edhe vetë qendrën komunale. Konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit i mundëson komunës lidhje të mira të komunikacionit me të gjithë vendin. Me shumicën e qyteteve kryesore të Kosovës lidhet brenda një distance prej rreth 40-55 km - Gjakovë 40 km, Prizren 44 km, Prishtinë 49 km, Pejë 52 km, Ferizaj 56 km. Distancat më të mëdha janë me Mitrovicën-75 km, si dhe me Gjiilanin - 80 km. Sa i përket lidhjeve ndërkombëtare, kalimi i autostradës Durrës-Merdarë përmes territorit të komunës e vë Malishevën në pozitë të volitshme.

Territori i komunës së Malishevës është kryesisht i përbërë nga zonat kodrinore-malore dhe të rrafshita. Hapësira komunale e cila kufizohet me terrenet kodrinore në pjesën lindore (në kufi me Drenasin, Lipjanin dhe Suharekën) dhe në Jug-perëndim (që në kufi me Rahovecin), si dhe shtrirja e sipërfaqeve të rrafshëta në qendër, ofrojnë një larmi të përmbajtjeve dhe potencialeve bujqësore, mjedisore dhe biodiversitetit. Format më të shpeshta të hasura në relievin e saj janë hurdhat dhe shpellat. E veçanta e kësaj komune është se atë e përshkon pellgu i lumit Mirusha, me toka të rrafshëta e pjellore në të dy brigjet e saj. Komuna rrethohet edhe me masivin malor të Drenicës, me pikën më të lartë mbidetare të saj prej 1,057 m tek Maja e Kosmaqit dhe 1,006 m tek maja e Koznikut.²

² Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

5.3 Topografia

Territori i komunës së Malishevës karakterizohet kryesisht me zonat kodrinore-malore, si dhe me pjesë fushore përgjatë rrjedhave ujore. Sipërfaqja e saj përshkruhet gjithashtu dhe nga pellgu i lumit Mirusha, i cili është i pasur me tokë të rrafshët dhe pjellore në të dy brigjet e saja. Ky pellg është i rrethuar me masivin malor të Drenicës me lartësinë mbidetare deri në 1057 m (Maja e Kasmaqit), Majën e Koznikut me lartësinë mbidetare deri në 1006 m. Format më të rëndësishme të relievit janë masivi malor, luginat e lumenjve dhe ultësira e Llapushës. Kjo ultësirë është krijuar me dy morfologji të përgjithshme, malet e Drenicës në lindje dhe lugina e Mirushës në qendër (500-650m) me shpate të ngushta posaçërisht në anën perëndimore, ku bie në një pjerrësi prej 45° tek ultësira e Llapushës. Kjo komunë po ashtu është e pasur dhe me shpella. Shpella më e njohur dhe më e rëndësishme është “Shpella e Flladit, në Panorc, me gjatësi të kanaleve prej 945 m (deri më tani e zbuluar), pastaj disa shpella tjera të rëndësishme sekondare në Kanjonin e lumit Mirusha”, në fshatin Bardhë-Guncat etj.³

5.4 Klima

Në territorin e komunës së Malishevës dominon kryesisht klima e mesme kontinentale, që karakterizohet me dimër të ftohtë (në fshatrat malorë) dhe verë të nxehtë (në fshatrat me të ulëta). Temperatura mesatare është 24.6° në verë, si dhe -10° C në dimër. Sasia mesatare e reshjeve është afër 755,5 mm^{3,4}

³ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

⁴ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

5.5 Hidrografia

Komuna e Malishvës është e pasur me një rrjet të burimeve ujore të shpërndara. Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Malishevës është Mirusha, i cili i takon pellgut të Drinit të Bardhë. Mirusha buron nga malet e Bllacës (masivi malor i Carralevës), ndërsa ky burim përbëhet nga dy degë (përrenj): përroi që rrjedh nga Nguncati dhe përroi që rrjedh nga Bllaca. Të dy këta përrenj bashkohen në hyrje të fshatit Bellanicë për të krijuar lumin Mirusha. Në pjesën e poshtme të lumit Mirusha, në një gjatësi 2 km, është krijuar një grykë me 16 liqene lumore të madhësive të ndryshme, të lidhura me njëri-tjetrin me një ujëvarë spektakulare me gjatësi prej 21 m. Duke pasur parasysh vlerat mjedisore që Mirusha përmban në rrjedhën e saj dhe hapësirat përreth, zona rreth saj është shpallur Monument Natyror me rëndësi të veçantë. Burim tjetër i rëndësishëm për këtë komunë është edhe burimi i ujit termal, i cili gjendet në fshatin Banjë, në anën e djathtë të lumit Mirusha. Në afërsi të këtij burimi është ndërtuar edhe pishina e hapur publike. Burime tjera të rëndësishme ujore në komunë janë: dy burime në fshatrat e Gurbardhit, burimet në fshatin Javiq dhe Panorc, rrjedha Belak në fshatin Maxharrë dhe burime të tjera ende të pa-evidentuara në malet e Gurbardhit.⁵

⁵ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

5.6 Rrjeti ekologjik

Komuna e Malishevës është e njohur për një rrjet ekologjik të pasur. Ndërtimi gjeologjik, peizazhi dhe kushtet klimatike kanë ndikuar që në një hapësirë relativisht të vogël të rezervuarit të lumit Mirusha të shfaqet një diversitet i pasur i faunës dhe florës. Sa i përket florës, në këtë territor janë gjendur 330 lloje të bimëve vaskulare dhe 44 lloje të kërpudhave të larta (makromicetet). Veçanti e florës së parkut është prania e tri bashkësive bimore endemike, e këto janë:

1. Ass. Polygalla Gensta hassertianae
2. Ass. Polygalla Forsythia eurpaea
3. Ass. Potentillo Fumanetum bonapartei

Drunjtë që rriten në territorin e kësaj komune janë ahu, lisi, thana dhe në rrethinat e Mirushës rriten shëlgjet. Nga barishtet rritet lulëkuqja (peonia decore), si dhe bimët mjekësore si bar-veshi, bar-pezmi, etj. Fauna në malet e Berishës karakterizohet me kafshë të egra si macja e egër, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, etj. Duke e pasur parasysh shtrirjen e sipërfaqeve pyjore në pjesët lindore dhe perëndimore kodrinore të territorit komunal, të pasura me një shumëllojshmëri të botës bimore dhe shtazore, si dhe korridoret përgjatë lumenjve që shtrihen përgjatë territorit komunal duke i lidhur këto tërësi pyjore, mund të thuhet se Komuna e Malishevës shquhet me një rrjet ekologjik i cili është i shpërndarë përgjatë tërë territorit të saj.⁶

5.7 Demografia

Zhvillimi i popullsisë është një kriter mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës, duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme. Në bazë të rezultateve të vlerësimit të popullsisë të realizuara nga ASK për vitin 2020, numri i banorëve në komunën e Malishevës është 56,936 banorë, dendësia e popullsisë është 190.41 banorë për km², shtimi natyror për vitin 2020 ka qenë 890, bilanci i migrameve për vitin 2020 ka qenë 325.

⁶ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

5.8 Zhvillimi Ekonomik

Burimi kryesor i gjenerimit të hyrave të qytetarëve të komunës së Malishevës janë prodhimtaria e vogël, bujqësia (ekonomitë familjare) dhe tregtia. Potencialet për zhvillim ekonomik nuk janë shfrytëzuar plotësisht deri më tani, ndërsa Malisheva i takon komunave më të pazhvilluara të Kosovës. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme. Bujqësia paraqet potencialin kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës, ndërsa nuk është trashëguar ndonjë industri nga periudha e para luftës. Malisheva ka kushte të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtysë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës.

5.9 Turizmi

Territori i komunës së Malishevës karakterizohet me potenciale të shumta të turizmit vikendor, natyror, kulturor dhe rural. Gjeomorfologjia e territorit të komunës së Malishevës e pasur me vargmale, burime e rrjedha ujore, ku përveq vlerave natyrore kjo komunë është e pasur dhe nga ana kulturore ku shumë prej të cilave tashmë janë të listuara si monumente natyrore dhe kulturore. Prandaj komuna e Malishevës paraqet potencial për zhvillim të turizmit. Një pjesë e madhe e potencialeve turistike shtrihen përgjatë Lumit Mirusha, përkatësisht përgjatë Korridorit të Gjellbër. Ky brez përmbledh vlera natyrore dhe kulturore të Malishevës, duke mundësuar lidhje atraktive jomotorike të pikave me interes për vizitorët, si dhe disa prej vendbanimeve kryesore, duke përfshirë edhe vet qendrën komunale. Në fshatin Banjë 3 km në verilindje të Malishevës, buron uji termal, kapaciteti i të cilit është 120-230 l/sec, me temperaturë konstante të ujit prej 22°C gjatë gjithë vitit. Kjo për komunën është edhe një vlerë tjetër turistike që ka potencial për zhvillim më të avancuar, duke filluar nga prej përmirësimit të kushteve si atraksion sportiv dhe rekreativ, e deri të ndërtimi i kapaciteteve për turizëm shëndetësor. Pika përfundimtare dhe kulminacioni i lëvizjes përgjatë Korridorit të Gjellbër janë Ujëvarat e Mirushës, si element qendror i Monumentit të Natyrës me rëndësi të veçantë. Vlerat e veçanta natyrore hidrologjike dhe të biodiversitetit e bëjnë këtë zonë atraktive për vizitorë të shumtë. Duke e pasur parasysh këtë fakt, është me rëndësi që Ujëvarat e Mirushës të shfrytëzohen si element për joshjen e vizitorëve drejtë Malishevës, duke nënkuptuar edhe orientimin drejt

atraksioneve tjera që i ofron komuna. Pastaj dy burime të ujit në fshatin Burim dhe Maxherre si dhe shumë burime të ujit në male të Berishës, shtojnë pasuritë natyrore të Komunës së Malishevës.

Përveç këtyre pikave, Malisheva ofron edhe atraksione tjera me vlera natyrore. Ndër më të shquarat janë Malet e Berishës, ku edhe shtrihet zona me interes të Veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë". Kjo hapësirë është atraktive për shkak të vlerave natyrore dhe mjedisore që i ofron, si dhe për trashëgiminë që rrjedh prej historisë më të re të Kosovës. Atraksion të veçantë parqet edhe Shpella e Panorcit, si monument speleologjik. Një tjetër segment të veçantë që mund të jetë atraktiv për vizitorët përbën trashëgimia kulturore dhe traditat lokale të Malishevës. Deri më tani në Malishevë janë listuar 67 monumente dhe lokacione, prej të cilave 19 paraqesin trashëgimi arkitekturale, 49 trashëgimi arkeologjike, 1 peizazh kulturor dhe 1 zonë e veçantë e mbrojtur.

Edhe pse turizmi ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor të një zone, zhvillimi i tij i pakontrolluar ka ndikim negativ në mjedis e në veçanti në ekosistemet natyrore si rezultat i hedhjes së pakontrolluar e mbeturinave, dëmtimit të resurseve natyrore dhe biodiversitetit. Me qëllim të zvogëlimit të këtij ndikimi krahas aspektit ekonomik, turizmi duhet ti kushtojë vëmendje edhe mbrojtjes së mjedisit, andaj si një formë e avancuar e turizmit sot njihet ekoturizmi apo turizmi i qëndrueshëm.⁷

⁷ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

5.10 Bujqësia


Komuna e Malishevës ka sipërfaqe të përgjithshme prej 30586.26 ha. Kryesisht kultivohen kulturat lavërtare/drithërat, perimet dhe pemët. Dikur në sipërfaqe të konsiderueshme kultivohen edhe hardhia e rrushit. Në tabelën në vijim është prezantuar struktura e shfrytëzimit të tokës në komunë. Sipërfaqja e përgjithshme e nxënies së tokave bujqësore është 1284.11 ha ose 4.10% sip. të përgjithshme të komunës.

Që të arrihet një zhvillim i mirëfilltë i bujqësisë në komunë nevojiten investime në mjete dhe teknologji të punës, hapje e mini fabrikave për përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Malisheva ka kushte shumë të mira fiziko natyrore të favorshme për zhvillimin e kulturave në pemëtari dhe vreshtari.

aktivitete bujqësore. Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 30586 hektarë, tokë e punueshme bujqësore është sipërfaqja prej 11735 hektarë ose 38%. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet kryesisht për kultivimin e drithërave, perime kulturave dhe të disa bimëve foragjere. Sektorit shoqëror shfrytëzohet për kultivimin e hardhisë së rrushit, pemishteve dhe të drithërave. Bujqësia në Komunën e Malishevës ende është ekstensive, ka shkallë të ulët të zhvillimit dhe është jo profitabile. Prodhimet bujqësore më tepër janë të dedikuara për konsum familjar e fare pak për treg. Sipas të dhënave që ka drejtoria përkatëse në KK të Malishevës del që çdo familje merret me bujqësi (numri i familjeve dhe numri i familjeve që merren me bujqësi sipas vendbanimeve). Shkaqet kryesore që sektori i bujqësisë nuk llogaritet si profitabil, janë:

- Kushtet natyrore (Vera e nxehtë dhe e thatë – mungesa e sistemit të ujitjes);
- Kushtet teknike (mos aplikimi i masave agroteknike);
- Kushtet shoqërore (mungesa e stimulimit – trajtimit, adekuat, dhe ofrimit të shërbimeve për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore etj.)



Humbja e tokës bujqësore

Mënyrat e humbjes së tokës bujqësore janë:

- Humbjet e përhershme të tokës (rrugët, akumulimet e ujit, aeroportet, ndërtesat e mëdha);
- Humbjet e përkohshme të tokës (mihjet sipërfaqësore, eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës, mbeturinat industriale, mbeturinat komunale, procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve etj.)

5.11 Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore

Territori i komunës së Malishevës është tejet i pasur me trashëgimi natyrore. Deri më tani janë të evidentuara 22 monumente të trashëgimisë natyrore, të cilat janë shpërndara përgjatë gjithë sipërfaqes komunale.

Monumentet Natyrore Hidrografike:

Si Monumente Natyrore Hidrografike janë të kategorizuara tri monumente:

- Ujëvarat e Mirushës,
- Burimi Termal në Banjë dhe
- Burimi në Gurbardh.

Monumenti Natyror Speleologjik:

Komuna e Malishevës karakterizohet edhe me prezencën e shpellave në Panorc, në Kanjonin e lumit “Mirusha”, në fshatin Bardhë-Guncat etj. Shpella më e njohur dhe më e rëndësishme është “Shpella e Flladit “, në Panorc, me gjatësi të kanaleve prej 945 m (deri më tani e zbuluar). Klasifikohet si Monument Speleologjik i Kategorisë III: shpella e Temeqinës, shpella e Bozhurit në Damenek, shpella e Lladrovit.⁸

Monumentet tjera natyrore:

Përveç monumenteve të sipër përmendura, në kuadër të territorit komunal të Malishevës janë të listuara edhe 19 monumente tjera të natyrës. Në kuadër të tyre përfshihen Malet e Berishës, Liqeni Artificial në Mirushë, rrjedha e lumit Mirusha me rëndësi hidrologjike dhe peizazhore, burimi në fshatin Burim, 4 shpella (Temeqinë, Ularicë, Bardh, Drenoc), 10 drunj karakteristik: trugu i Qarrit në Lladrov, Carravanë, Drenoc, Bubël, Bellanicë, 5 trungjet bungutës me karakter botanik në fshatin Llozicë, Guriq, trugu i frashrit gjethengushtë në Javiq dhe Zabeli dhe Vrella në Vërmicë. Prej këtyre monumenteve, Malet e Berishës klasifikohen në kategorinë III, për shkak të vlerave të medha mjedisore që i ka.⁹

Trashëgimia kulturore

Komuna e Malishevës ka disa monumente të vjetra, ndërtesa religjioze si xhami e kisha, shtëpitë të ndërtuara në mënyrë tradicionale si dhe objekte të tjera të vjetra si ura të cilat duhet të ruhen dhe konservohen për shkak të vlerat të tyre kulturore. Në komunën e Malishevës ekzistojnë potenciale të rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale. Në shumëllojshmërinë e vet kjo trashëgimi kulturore përfshinë objekte të trashëgimisë arkitekturale, arkeologjike, peizazh kulturor dhe një zonë të veçantë të mbrojtur. Numri i objekteve dhe i tërësive të trashëgimisë kulturore në Malishevë është 67.¹⁰

Trashëgimia arkitekturale

Në kuadër të listës së trashëgimisë arkitekturale përfshihen 20 objekte, të ndërtuara gjatë shekujve XVIII - XX. Kjo listë përfshinë një shumëllojshmëri objektesh - kulla, shtëpi, hambare, mulli, ura dhe objekte fetare që janë të shpërndara përgjatë tërë territorit komunal. Nga 20

⁸ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

⁹ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

¹⁰ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

objektet e trashëgimisë arkitekturale te identifikuara, 6 janë të përfshira në listën e MKRS, 5 në listën e Komunës së Malishevës, ndërsa 9 nuk kanë status të mbrojtjes. Deri më tani është restauruar vetëm një objekt - ura e shekullit XVIII në fshatin Bubël, e njohur si Ura e Arabaxhive, e cila e lidhte Rrafshin e Kosovës me atë të Dukagjinit.¹¹

Trashëgimia arkeologjike

Lista e trashëgimisë arkeologjike është mjaft e pasur dhe e përfshinë tërë territorin komunal. Në kuadër të trashëgimisë arkeologjike përfshihen 2 monumente/ansambël, 11 lokalitete arkeologjike/rezervat te cilat janë në listën e MKRS. Gjithashtu Komuna ka identifikuar mbetje arkeologjike tjera te cilat nuk janë të futura në listën e MKRS-së.¹²

Zona e veçantë e mbrojtur:

Në komunën e Malishevës si Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM) është klasifikuar edhe Kisha e Heremitëve, në Ularicë. Kjo ZVM shtrihet në komunat Malishevë dhe Klinë. Sipërfaqja e mbrojtur dhe zhvillimet përreth kësaj zonë duhet përcaktuar sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Nr.03/L-039 dhe Ligjit për Planifikim Hapësinor Ligji Nr. 04/L-174 neni 18. Kisha e Heremitëve gjendet brenda Zonës Monumenti me rëndësi të Veçantë Ujëvarat e Mirushës.¹³

¹¹ Plan i Zhvillimit Komunal Malishevë 2019-2027

¹² Plan i Zhvillimit Komunal Malishevë 2019-2027

¹³ Plan i Zhvillimit Komunal Malishevë 2019-2027

6. GJENDJA E MJEDISIT

Ligji për VSM-në kërkon që Raporti i VSM-së të përfshijë gjithashtu një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evulimin e saj të mundshëm pa zbatimin e planit ose programit, si dhe një përshkrim të çfarëdo problemi ekzistues mjedisor. Ky kapitull përmbush këtë kërkesë të Ligjit Nr.03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Si një nga komunat më të pazhvilluara në vend, Malisheva ka një mjedis relativisht të pastër, por ajo është larg nga të qenit jo e ndotur. Kontaminimi i tokës dhe ujit, me mbetjet e ngurta dhe ujërat e zeza, guroret, degradimi i pyjeve, humbja e tokës bujqësore përmes ndërtimit të paligjshëm janë kërcënime aktuale nëpër tërë territorin e komunës. Studimet hulumtuese dhe profesionale për përcaktimin e normës së ndotjes (ujit, tokës dhe ajrit) në komunë nuk janë bërë ende. Ky problem nuk është i pranishëm vetëm në komunë, por është i pranishëm edhe në nivel vendi. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të përmirësojë ndjeshëm gjendjen në mbrojtjen e mjedisit. Që nga pas lufta një ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohet kjo komunë është edhe ndotja e mjedisit. Ndotja e mjedisit është një problem mjaft serioz, prezent pothuaj në gjithë territorin e Kosovës e poashtu edhe në komunën e Malishevës. Ndotja dhe degradimi i mjedisit në këtë komunë bëhet më së shumti nga faktori antropogjen me veprimet e tij të cilat janë: Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, menaxhim jo i duhur i ujërave të zeza dhe mungesa e trajtimit të tyre, degradimi i pyjeve dhe prerjet ilegale në rritje, cilësia jo e mirë e ajrit në zonat urbane dhe mungese e inventarit të ndotësve të ajrit, cilësi dhe sasi e pamjaftueshme e ujit sipërfaqësor dhe ujit të pijes, trajtimi jo i duhur i mbeturinave, krijimi i vazhdueshëm i deponive ilegale nga qytetarë të papergjegjshëm, humbja e tokës me cilësi të lartë bujqësore nga zgjerimi i vendbanimeve dhe zonave industriale si dhe toka të degraduara që e zvogëlojnë vlerën e peizazhit rural, fragmentimi dhe shëndërrimi i tokës, mbrojtje jo e mjaftueshme e biodiversitetit, mungese e organeve menaxhuese për zona të mbrojtura dhe e planeve lokale për mbrojtjen e biodiversitetit. Zbatim i pamjaftueshëm i VNM-së nga personat e licencuar nga Ministria e Mjedisit për planet, programet dhe projektet e nivelit lokal të cilat nëse përgatitet nga profesionistët e fushës do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës. Trashëgimia Kulturore dhe natyrore ka mbrojtje të pamjaftueshme. Në projektet e shumta të infrastrukturës mungojnë korridoret ekologjike, të cilat mundësojnë ruajtjen e llojeve në zonat me potencial për biodiversitet të pasur. Problem serioz për shëndetin e qytetarëve të kësaj

komune është mungesë e vetëdijes mjedisore dhe pjesëmarrje e ulët në vendimmarrjen mjedisore.

Ndotja e ujit

Territori i komunës së Malishevës ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit Adriatik. Në komunë, lumi kryesor është Mirusha me degët e saj. Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale pa asnjë trajtim paraprak në lumin Mirusha rritë shkallën e ndotjes së lumit. Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjtë ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat që i hedhë popullata lokale, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shpërlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, etj.

Ndotja e ajrit

Gjendja mjedisore në Kosovë nuk është e knaqshme shikuar nga aspekti i përgjithëshem, mirëpo komuna e Malishevës nuk ballafaqohet shumë me këtë problem. Shkaktarët që bëjnë ndotje të mjedisit dhe të ajrit janë: komunikacioni në zonën urbane, mbeturinat komunale, pluhuri, zhurma etj.

Ndotja e tokës

Territori i komunës së Malishevës përbëhet kryesisht nga këto tipe të tokave: smonica, smonica e eroduar në pseudoglej, smonica e kuqe, e kuqe malore, e përhimtë e lesiviruar, pseudoglej, e kaftë e lesiviruar, rendzinë, dhe tokë aluviale argjilore. Përbërja kimike dhe fizike e këtyre tokave dallon. Për ato që nuk janë, me masa të ndryshme melorative (që zakonisht janë të konsiderueshme në aspektin financiar) gjendja mund të përmirësohet. Tokat në komunë kryesisht kanë dy destinacione, për bujqësi dhe për ndërtime. Kjo komunë është më pak e zhvilluar në aspektin ekonomik, prandaj nuk kemi ndotje të tokës nga industria, por ajo ndotet nga mbeturinat nëpër fshatra, ujërat e zeza, pikat e shitjes së karburanteve, ndërtimet pa leje, rregullimi i rrugëve dhe rikonstruksioni i tyre, etj. Por, një tjetër faktor që ndikon në ndotje është edhe rritja çdo ditë e popullsisë dhe kjo kryesisht në zonat urbane e shkaktuar nga migrimi fshat-qytet. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, në këtë komunë menaxhimi fillimisht bëhet në Malishevë, Bajë dhe Kijevë. Ndërmarrja publike, mbeturinat e grumbulluara i dërgon në deponinë regjionale në Landovicë të Prizrenit. Sa i përket mjedisit vazhdimisht paraqiten vështirësi në vlerësimin e gjendjes mjedisore në regjion për shkak të mungesës së monitorimit mjedisor.

Mbeturinat e ngurta të akumuluar në deponitë ilegale janë ndër ndotësit kryesorë të tokës në komunë. Këto janë kryesisht deponi ilegale të mbeturinave shtëpiake, dhe në disa raste mbetjeve të ndërtimit, të cilat kryesisht gjenden në afërsi të rrugëve. Ndikimet negative të këtyre deponive janë të shumta, ku përveç kontaminimit të drejtpërdrejtë të tokës dhe ajrit, ndikimi i tyre mund të bartet në rrjedhat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nëpërmjet reshjeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike për çdo vit e bën evidentimin e deponive ilegale dhe organizon pastrimin e tyre.

Ndotja akustike

Sa i përket ndotjes nga akustike nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme. Fakti që përmes territorit të komunës kalon autostrada që lidh Kosovën me Shqipërinë, rruga nacionale Prishtinë - Pejë N9, si dhe rrugët regjionale, do të thotë se komuna është e ndikuar nga zhurma. Gjithashtu ndotësit tjerë janë veprimtaritë përpunuese/industriale siç janë fabrika e betonit/çimentos pranë vendbanimit Bellanicë dhe gërmimet grumbulluese (gurthyesit) brenda territorit të komunës.¹⁴

Ndotja nga mbeturinat

Komuna e Malishevës gjatë viteve të fundit është duke shënuar progres në procesin e menaxhimit të mbeturinave. Menaxhimi i mbeturinave në komunë kryhet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ekoregjioni" - Njësia Operative në Malishevë. Shtrirja e këtij shërbimi i përfshinë 38 vendbanime, ndërsa të përfshira mbeten Berisha, Lladroviqi, Pllaqica, Fshati i Ri, Gollubovci dhe Kërvasaria. Mbeturinat e grumbulluara komunale dërgohen në deponinë regjionale në Landovicë. Kompania e shfrytëzon edhe një deponi transite në afërsi të rrugës Malishevë-Mirushë, por e cila nuk është e miratuar nga komuna. Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të shërbimit të mbeturinave në komunë është 5991 njësi. Prej këtij numri, 5346 (89%) janë amvisëri, 585 (10%) shfrytëzuesit komercial dhe 60 (1%) shfrytëzuesit publik. Sa i përket vendbanimeve, prinë Malisheva me 907 shfrytëzues (15%), dhe Banja me 428 shfrytëzues (7%). Shikuar përgjithësisht, menaxhimi i mbeturinave ende paraqet problem të pazgjidhur plotësisht, pasi ende ka shfaqje të deponive ilegale, që janë ndër ndotësit kryesorë të tokës në komunë.

¹⁴ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

Zonat e mbrojtura

Numri i zonave të mbrojtura në Komunën e Malishevës është njëzetë (20). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 4 Monumente të Natyrës me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik, 14 Monumente të Natyrës me karakter botanik, 3 Monumente të Natyrës me karakter hidrologjik, dhe 1 Monument i Natyrës me karakter speleologjik.

- **Ujëvarat e Mirushes**- Monument natyror me karakter gjeomorfologjik, hidrologjik, Speleologjik, botanik, peizazhor, më rëndësi shkencore dhe turistike;
- **Trungjet e bungut (Quercus sp.) në Lozice**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Rrjedha e lumit Mirusha**- Monument natyror me karakter hidrologjik;
- **Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) në Lladrovç**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Shpella e Temeqinës**- Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik;
- **Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) në Carravranë**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Trungu i Bungëbutës (Quercus pubesens Willd) në LLozicë**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Trungu i Bungëbutës (Quercus pubesens Willd) në LLozicë**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Shpella e Bozhurit në Damanek**- Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik;
- **Shpella e Lladroviqit**- Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik;
- **Trungu i Bungëbutës (Quercus pubesens Willd) Guriq**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) ne Drenovç**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) në Bubë**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) në Bubël**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) në Bellanic**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Trungu i frashrit gjethengushtë (Fraxinus angustifolia Vahl) në Javiq**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Vakëfi i Vermicës**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Zabeli dhe vrella ne Javiq**- Monument natyror me karakter botanik;
- **Burimi i ujit ne Carravranë**- Monument natyror me karakter hidrologjik;

- **Shpella e Ponorcit**- Monument natyror me karakter speleologjik;

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, natyra dhe vlerat e trashëgimisë natyrore janë me interes për Republikën e Kosovës dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Ujëvarat e Mirushës

Ujëvarat e Mirushës janë atraksion që e pasuronë territorin e Komunës së Malishevës me një biodiversitet të pasur bimorë, shtazor dhe peizazhor. Për shkak të këtyre vlerave që disponon kjo zonë, Ujëvarat e Mirushës janë shpallur Park Regjional i Natyrës në vitin 1982/83 nga Komuna e Klinës dhe Rahovecit, tanimë e trashëguar nga Komuna e Malishevës, me sipërfaqe prej 555.80.70 ha. Ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2012 nxjerr vendim për shpalljen e Ujëvarave të Mirushës Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë me sipërfaqe të përgjithshme prej 598.4 ha, dhe i takon kategorisë III. Në mars të vitit 2014 Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Planin Hapësinore për zonën e mbrojtur “Ujëvarat e Mirushes”, të hartuar nga




Figure 1. Ujëvara e Mirushës

Instituti për Planifikim Hapësinor Kanjoni i Mirushës është një ndër zonat më interesante të natyrës së Kosovës, e cila përfshinë pjesën e poshtme të rrjedhës së Mirushës. Në këtë pjesë të kanjonit janë 16 ujëvara me liqene që e përbëjnë pjesën më atraktive të kanjonit. Në kuadër të territorit të monumentit gjendet Kisha e Eremitëve - fshati Ularicë, e cila mbrohet me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Flora dhe vegjetacioni është mjaft i pasur me lloje dhe bashkësi bimore e shtazore. Në territorin e Parkut të Mirushës gjenden 330 lloje të bimëve vaskulare, duke mos i llogaritur bimët e ulëta dhe myshqet. Nga bimët e ulëta janë evidentuar 44 specie kërpudhash të larta (makromicetesh), ndërsa në territorin e gjerë të rajonit të Mirushës janë prezentë 838 taksone bimore të përfaqësuara me 590 lloje të bimëve vaskulare. Veçanti e florës së rajonit të Mirushës është prania e 14 bashkësive (asociacioneve) bimore, 5 prej të cilave kanë karakter endemik, ndërsa numri i llojeve endemike është 21. Prej tyre lloji *Aristolochia merxmuelleri* është lloj stenoendemik dhe deri tani në nivel botëror është konstatuar vetëm në këtë rajon në disa lokalitete relativisht të ngushta. Fauna – Në rajonin e Mirushës janë vërejtur këto lloje të shtazëve: derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), lepur (Lepus europaeus), ketri (*Sciurus vulgaris*), ujku (*Canis lupus*), maca e egër (*Felis silvestris*), Sqarthe (*Martes martes*), miu bizam (*Ondatra zibethica*), miu i verdhë malor (*Apodemus flavicollis*), iriqi (*Erinaceus concolor* L.), breshka e tokës (*Testudo* sp.). gjarpëri helmues i gurit (*Vipera amodytes*). etj. Përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha ekzistojnë kushte të volitshme për jetën e shumë ujëtokësorëve dhe peshqve.¹⁵

Zonë tjetër e rëndësishme është dhe Burimi Termal në Banjë, i cili klasifikohet si Monument Natyror Hidrografik i Kategorisë III. Burimi i ujit termal ka kapacitet 250-300 l/sec, ndërsa mbi këtë burim të ujit është ngritur pishina me sipërfaqe 2000 m², e cila çdo sezon vere është në shfrytëzim për freskim dhe gara të notit. Uji i kësaj pishine ofron edhe mundësi shërimi nga një numër i caktuar i sëmundjeve të lëkurës. Temperatura konstante e ujit gjatë tërë vitit është 22°C. Ky vend vlerësohet me potencial për turizëm, rekreacion, sport dhe rehabilitim.¹⁶

¹⁵ Biodiversiteti i Kosovës-AMMK

¹⁶ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

Flora

Në Komunën e Malishevës ekziston një larmi e bimësisë siq janë: Pendëkaposhi i Mayerit (*Stipa mayer* Mart.), Petriku i Grojterit (*Aristolochia merxmulleri* Greuter et Mayer), të cilat gjendet në zonën e Mirushës dhe është në listën e bimëve endemike të florës vaskulare, karakteristike për Kosovën ¹⁷; Gipsofilë (*Gypsophila spargulifolia* Griseb.), e cila është bimë e rrallë; Lule Bozhuri-bozhuri dekorativ (*Paeonia decora* Anders.), të cilat gjenden në territorin e Malishevës. Drunjtë që rriten në këtë territor janë ah, lisi, thana dhe në rrethinat e Mirushës rriten shëlgjet. Nga barishtet rritet lulëkuqja (peonia decora), si dhe bimët mjekësore si bar-veshi, bar-pezmi, etj. Disa nga llojet e tjera bimë në këtë komunë janë: *Coronopus squamatus* (Forssek.) Asch. *Cirsium canum* (L.) All.; *Lolium perenne* L.; *Matricaria chamomilla* L.; *Poa annua* L.; *Polygonum aviculare* L.; *Sclerochloa dura* (L.) P.B. Beauv.; *Taraxacum campylodes* G. E. Haglun; *Trifolium nigrescens* Viv.; *Trifolium pratense* L.

Fauna

Territori i komunës së Malishevës karakterizohet me kafshë të egra si macja e egër, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, etj.

Llojet e Faunës në Komunën e Malishevës në Librin e kuq të Faunës

	Lloji i Faunës	Emri shqip	Statusi i kercenueshmerise ne Kosove (sipas kriterëve te IUCN-se)
1.	<i>Phengaris arion</i> (L.)	Kaltëroshja njollazeze	Rrezikuar, EN B2ab (iii, iv)
2.	<i>Lycaena dispar</i> (Haworth)	Fluturza e bakërt e madhe	I Cenuar, VU A2ac; B2ab (iii, iv)
3.	<i>Hipparchia fagi</i> (Scop.)	-	Gati i Kërcënuar, NT
4.	<i>Pyrgus sidae</i> (Esper)	-	I Cenuar, VU A2ac; B2ab (iii, iv)
5.	<i>Hipparchia statilinus</i> (Hufnagel)	-	Gati i Kërcënuar, NT
6.	<i>Hipparchia volgensis</i> (Mazochin-Porshnjakov)	-	Gati i Kërcënuar, NT

¹⁷ Flora Vaskulare Endemike e Kosovës

7.	<i>Testudo hermanni</i> (Gmelin)	Breshka e zakonshme	Gati i Kërcënuar, NT
8.	<i>Rhinolophus hipposideros</i> (Bechstein)	Lakuriq nate hundpatkua i vogël	Gati i Kërcënuar, NT
9.	<i>Carcharodus alceae</i> (Esper)	-	Shqetësim më i Vogël, LC
10.	<i>Pelophylax ridibundus</i> (Pallas)	Bretkosa e kënetës	Shqetësim më i Vogël, LC
11.	<i>Canis lupus</i> (L.)	Ujku	Shqetësim më i Vogël, LC
12.	<i>Vulpes vulpes</i> (L.)	Dhelpra	Shqetësim më i Vogël, LC
13.	<i>Anguilla Anguilla</i> (L.)	Ngjala	Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)
14.	<i>Carcharodus floccifera</i> (Zeller)	-	I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)
15.	<i>Pyrgus sidae</i> (Esper)	-	I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)
16.	<i>Macedonica frauenfeldi</i> (Ross.)	-	Gati i Kërcënuar, NT
17.	<i>Chazara briseis</i> (L.)	Briseida	Gati i Kërcënuar, NT
18.	<i>Cupido decolorate</i> (Staudinger)	-	Gati i Kërcënuar, NT
19.	<i>Hipparchia volgensis</i> (Mazochin-Porshnjakov)	-	Gati i Kërcënuar, NT
20.	<i>Papilio machaon</i> (L.)	Flutura Bajrake	Gati i Kërcënuar, NT
21.	<i>Podarcis tauricus</i> (Pallas)	Hardhuca e barit	Gati i Kërcënuar, NT
22.	<i>Myotis blythii</i> (Tomes)	Lakuriq nate veshmiu i vogël	Gati i Kërcënuar, NT
23.	<i>Myotis myotis</i> (Borkh.)	Lakuriq nate, veshmiu i madh	Gati i Kërcënuar, NT
24.	<i>Podarcis muralis</i> (Laurenti)	Hardhuca e mureve	Shqetësim më i Vogël, LC
25.	<i>Vipera ammodytes</i> (L.)	Nepërka ose hundraku	Shqetësim më i Vogël, LC
26.	<i>Melitaea aurelia</i> (Nick.)	-	Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD
27.	<i>Podarcis erhardii</i> (Bedriga)	Hardhuca e gurëve	Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

28.	<i>Myotis capaccinii</i> (Bonaparte)	Lakuriq nate gishtgjatë	Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD
29.	<i>Myotis daubentonii</i> (Kuhl)	Lakuriq nate i Daubenton-it	Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Table 1 Disa lloje të Faunës në Komunën e Malishevës sipas Librit të kuq

Pyjet

Territori i komunës së Malishevës përfshinë një sipërfaqe prej 14421.46 ha zone pyjore. E tërë sipërfaqja pyjore kategorizohet si e mbrojtur, pa destinim për ndonjë qëllim komercial. Një pjesë e pyjeve janë të dëmtuara (të prera), pasi burimi kryesor për nxehje në komunën e Malishevës është lënda e drurit.¹⁸ Sa i përket florës, drunjtë që rriten në këtë territor janë ahu, lisi, thana dhe në rrethinat e Mirushës rriten shëlgjet. Fauna në malet e Berishës karakterizohet me kafshë të egra si macja e egër, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, etj. Duke e pasur parasysh shtrirjen e sipërfaqeve pyjore në pjesët lindore dhe perëndimore, kodrinoret të territorit komunal janë të pasura me një shumëllojshmëri të botës bimore dhe shtazore, si dhe korridoret përgjatë lumenjve që shtrihen përgjatë territorit komunal duke i lidhur këto tërësi pyjore, mund të thuhet se Komuna e Malishevës shquhet me një rrjet ekologjik i cili është i shpërndarë përgjatë tërë territorit të saj. Ky rrjet ofron potenciale hapësinore, mjedisore, si dhe të qarkullimit, andaj ato duhet të mbrohen dhe trajtohen në mënyrë qëndrueshme në të ardhmen.

¹⁸ Plani Zhvillimor Komunal Malishevë 2019-2027

Gjatë Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Komunën e Malishevës janë përfshirë këto kategori:

Elementet e përfshira në VSM	Kategoritë e përdorura gjatë vlerësimit Strategjik Mjedisor
Toka	Toka (përfshirë shfrytëzimin e tokës, zona të rëndësishme gjeologjike, ndotja e tokës dhe masat për mbrojtjen e tokës.
Uji	Burimi dhe cilësia e ujit (përfshirë ujërat e freskët të sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësor, lumenjtë, erozioni)
Ajri	Cilësia e ajrit, kualiteti i cilësisë së ajrit – monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit
Popullsia	Popullsia (numri i popullsisë, përfshirë efektet socio-ekonomike dhe qasja)
Shëndeti e popullsisë	Shëndeti i popullsisë, mbrojtja e shëndetit
Faktorët klimatikë	Ndryshim i klimës (përfshirë emetimet e gasrave të serrave, efektet e parashikuara nga ndryshimi i klimës sikur: përmbytjet dhe aftësitë për t'u përshtatur- adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike
Mbeturinat	Menaxhimi i qëndrueshem i mbeturinave
Ujërat e zeza	Trejtimi i ujërave të zeza
Trashëgimia natyrore dhe trashëgimia kulturore,	Trashëgimia natyrore (monumentet e natyrës) si dhe trashëgimia kulturore (përfshirë trashëgiminë arkologjike dhe arkitektonike)
Peizazhi	Peizazhi dhe pamja e qytetit
Energjia	Furnizimi me energji elektrike
Bujqësia	Menaxhimi i tokave bujqësore dhe shfrytëzimi i tyre
Biodiversiteti, (bota bimë dhe bota shtazore);	Ruajtja e biodiversitetit dhe natyrës (që përfshinë botën bimë dhe shtazore, dhe funksionimi i ekosistemeve) etj.
Zhurma	Ndikimi i zhurmës, masat për mbrojtjen nga zhurma.

7. IDENTIFIKIMI I VEPRIMEVE STRATEGJIKE NË MJEDIS

METODOLOGJITË PËR VLERËSIMIN E NDIKIMEVE

Metodologjia që është përdorur për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimit strategjik mjedisor është planifikuar të marrë në konsideratë natyrën e ndryshme të ndikimeve bio-fizike, social-ekonomike, dhe ndikimet mjedisore. Ndikimet bio-fizike në këtë kontekst janë me të përhapura në kuadrin e përcaktimit të kufijve dhe limiteve si dhe përcaktimit të sasisë, ndërsa ndikimet social-ekonomike janë potencialisht me të përhapura dhe janë objekt i një përjasje cilësore. Në paraqitjen e përgjithshme të rëndësisë së ndikimeve rezultatat që dalin nga kjo metodologji paraqesin një përmbledhje të hartuar të ndikimit mjedisor dhe social.

NDIKIMET BIOLOGJIKE

Në këto zona gjatë fazës së aktiviteteve të ndërtimit ka disa ndikime të vogla të cilat do të paraqiten siç janë: marrje e përkohshme dhe e përhershme e tokës, ndarje e përkohshme e habitateve dhe ndryshime në hidrologjinë sipërfaqësore dhe nëntokësore, depozitimin e materialeve në sheshe, ndotja apo derdhjet aksidentale të karburantit e materialeve të tjera, depozitimi i pluhurit (psh mbi gjethe apo sipërfaqen e dheut), shqetësim i specieve nga zhurma, dridhjet dhe drita, shqetësim jo-specifik për specie (psh zogjtë) për shkak të pranisë së punëtorëve dhe makinerive të ndërtimit.

Ndikimet kryesore që do të shfaqen gjatë fazës së shfrytëzimit janë: marrje e përhershme e tokës nga ndërtimi i strukturave të reja, ndryshime të përhershme në hidrologjinë sipërfaqësore dhe nëntokësore, degradim i dherave prej derdhjeve nga shfrytëzimi etj.

LISTA E ZONAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS SIPAS HARTËS ZONALE

Sipas Hartës Zonale teritori i Komunës së Malishevës është ndarë në këto zona:

- Zona Bujqësore (ZB)
- Zona Pyjore (ZP)
- Zona Banim (ZB)
- Zonë e Shfytëzimit të përzier (ZShP)
- Zona Industriale (ZI)
- Zona Komercale (ZK)
- Zona Turistike – Rekreative (ZTR)
- Zona e Minierës Sipërfaqësore (ZMS)
- Sipërfaqe Ujore (SU)

ZONAT MBISHTRESORE

- Zonë e Mbrojtur - Trashëgimi Natyrore,
- Zonë e Mbrojtur - Trashëgimi Kulturore e Historike,
- Zonë Mbishtresore e Ndikuar nga Vërshimet,
- Zonë Mbishtresore e Ndikuar nga Erozioni,
- Zonë Mbishtresore e Ndikuar nga Ndotja (e ajrit, tokës, ujit),
- Zonë Mbishtresore e Ndikuar nga Tërmeti,
- Zonë Mbishtresore e Ndikuar nga Zjarret,
- Zonë Mbishtresore e Ndikuar nga Ethet Hemorragjike.

7.1 ZONA BUJQËSORE

Komuna e Malishevës është një ndër komunat në Kosovë që paraqet potencial për zhvillim të tokës bujqësore, mirëpo që shumë pak është zhvilluar. Toka bujqësore në komunën e Malishevës kryesisht akomodon tokën e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore siq janë: fidanishte, pemishte, vreshta, arë, livadhe, kullota, hurdha peshku dhe moçale, si dhe tokat tjera që nuk janë në shfrytëzim për qëllime bujqësore, por që shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor, duke marrë parasysh vetitë e tyre natyrore dhe kushtet ekonomike. Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm, ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera përveç në rastet e përcaktuara më ligj dhe me dispozitat e tjera të nxjerrura në bazë të tij. Për të mundësuar prodhimtari të rregullt dhe të sigurt me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, botës bimore, shtazore dhe ambientit, zbatohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja. Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja bëhet me ndalim, kufizim dhe parandalim nga bartja direkte, bartja përmes ujit dhe ajrit e materieve të dëmshme dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë.




Figure 2. Harta Zonale e shfrytëzimit të tokës bujqësore

Sipas hartës zonale, zona bujqësore ndahet në: kategorinë e tokës I-IV, kategorinë e tokës V-VIII, zona bujqësore përgjatë lumit Mirusha dhe zona bujqësore në kuadër të zonës së veçantë të mbrojtur - Shtabi i Përgjithshëm i UCK-së i Kleckës dhe Divjakës. Ndikimet kryesore në bujqësi do të jenë: humbje e përkohshme/përhershme e përqasjes tek fushat bujqësore, ndryshim i përkohshëm/përhershëm i përqasjes tek fushat bujqësore, marrje e përkohshme/përhershme e tokës, copëzim i përhershëm i pronave fillestare, shqetësim i përhershëm i punimeve të ujitjes dhe/ose kullimit.

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Bujqësore - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Ndikimi në Komponentën Mjedisore Zona Bujqësore	Rekomandime
Ndikimi në tokë: Ndërtimi i fermave të mesme dhe të mëdha për mbarështimin e kafshëve dhe shpezëve dhe ndërtesat e tyre përcjellëse. Ndërtimi i depove për mjete të punës, depo për mekanizëm bujqësor, depo për ruajtjen e ushqimit për bagëti, hangarët për sanë, depo për silazh, depo për misër, ahur, dhoma frigoriferike dhe tharëse, ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës, ndërtimi i ndërtesave të reja tranzite, komunale, energjetike, të telekomunikacionet dhe rrugëve. Mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve, etj.	Masat zbutëse për tokën: - Rekomandohet që të gjitha këto aktivitetet të lejuara ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Lejes Mjedisore, të identifikohen mundësitë për minimizimin e efekteve negative në mjedis, ndalohet lëshuarja e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e dëmtojnë dhe ndryshojnë aftësinë prodhuese të tokës bujqësore apo kualitetin e kulturave bujqësore dhe përdorimi jo i drejtë i plehrave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e bimëve. Ruajtja e karakterit rural të tokëve bujqësore. - Nëse vjen deri tek ndotja e tokës bujqësore me lëshuerjen e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme në sasi më të madhe se sa është e lejuar, ndotësi i tokës bujqësore i bartë shpenzimet e veprimeve për dekontaminim, përkatësisht për sanim të tokës bujqësore. - Menaxhimi i drejtë i plehut, menaxhimi i lëvizjes së kafshëve dhe transportit të

	furnizimeve duhet të bëhet ashtu që të minimizoj pengesat në lëvizjen e banorëve dhe trafikut lokal.
Ndikimi në ujë: Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ndërtuese, si dhe gjatë transportit të materialit ndërtues (vajra lubrifikant, karburant) nga mjetet transportuese. Ndryshimi i rrjedhjes së ujërave, përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike. Përdorimi i pa kontrolluar i pesticideve, pleherave artificiale, si dhe zhvillimi i aktiviteteve që do të ndikonin në dëmtimin e vlerave të zonave të mbrojtura.	Masat zbutëse për ujin: - Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH. - Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna - Ndririmi i vajrave të makinerive transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës, rrjedhjet e ujërave dhe agjentëve atmosferik. - Të zbatohet UA-nr. 13/07 Masat mbrojtëse për burimet ujore që përdoren për pije. - Kufizimi i përdorimit të pa kontrolluar të pesticideve, pleherave artificiale, si dhe zhvillimi i aktiviteteve që do të ndikonin në dëmtimin e vlerave të zonave të mbrojtura.
Ndikimi në ajër: Ndotja e ajrit ndikohet nga pluhuri i liruar gjatë ndërtimeve të reja, sasia e mbeturinave të gjeneruara, energjia e cila përdoret për ngrohje, lirimi i gazërave gjatë përdorimit të mjeteve bujqësore.	Masat zbutëse për ajrin: - Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore, ndalimi i përdorimit të thëngjillit dhe drurit për ngrohje. - Reduktimi i ndotjes së ajrit duke përdorur konvertorë katalitik për automjetet e vjetra, të zbatohen masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit sipas Planit Lokal për Cilësi të Ajrit 2020-2024. - Të zbatohet plani i masave për përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Kosovë, MMPH tani (MEA). - Të zbatohen masat sipas Strategjisë për Cilësinë e Ajrit, 2013-2022 MMPH tani

	(MEA).
Biodiversiteti: Flora dhe fauna rrezikohen nga faktorët antropogjen, peizazhi lokal do të ndryshohet, nga tokë bujqësore në tokë të ndërtuar me objekte për infrastrukturë blegtorale. Mbjellja e monokulturave, grumbullimi i kërpudhave, bimëve dhe pjesëve të tyre, shqetësimi, vrasja ose kapja e shtazëve, gjuetia.	Masa zbutëse për biodiversitet: - Duhet të shmangen zonat e pasura me biodiversitet. - Të ruhen llojet e rralla bimore dhe shtazore të cilat jetojnë në ato zona, ndalohet gjuetia pa pasur leje nga autoritet përkatëse, ndalohet mbledhja e llojeve bimore dhe shtazore që janë të rrezikuara - në librin e kuq. - Trajtimi adekuat e etheve hemorragjike.
Peizazhi: Peizazhi lokal do të ndryshohet, nga tokë bujqësore në tokë të ndërtuar me Infrastrukturë blegtorale.	Masa zbutëse për Peizazh: - Për të ruajtur karakterin peizazhor të zonës, e veçmas ndikimin të komuniteti lokal, infrastruktura. - Përdorimi racional i burimeve natyrore, mbrojtja e biodiversitetit dhe llojshmërisë, rivitalizimi dhe rehabilitimi i peizazhit në harmoni me regjimin e mbrojtjes. - Shmangien e dëmtimit të përhershëm të sistemeve natyrore.
Mbeturinat: Ndikime negative mund të paraqiten nëse nuk menaxhohen si duhet mbeturinat e shkaktuara nga aktivitetet e lejuara. Deponimi i mbeturinave dhe lëshimi në ujërave të ndotura.	Masa Mbeturinat: - Sasia e mbeturinave që do gjenerohen gjatë realizimit të aktivitetetve të lejuara duhet të hedhen në lokacion të caktuar nga komuna dhe të njëjtat duhet të mbledhen nga shërbimi komunal. - Zgjerimi i mundësive për riciklimit të mbeturinave. - Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave, ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave. - Mbeturinat e forta duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna. - Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme,

	të zbatohet UA-nr.15/2012 - Për menaxhimin e deponive të mbeturinave, të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese, të zbatohet UA-nr. 06/2018 Për ndeshkimet me gjoba.
Zhurma: Punët montuese ose nga makineritë bujqësore.	Masa zbutëse për Zhurmën: - Niveli i zhurmës duhet të jetë nën kufijtë e standardit dhe gjatë punës nuk duhet të kalon 40 Db sipas standardeve ndërkombëtare dhe dispozitave ligjore që tani janë në fuqi. Makineritë me të cilat operohet për transport, të jenë të kontrolluara teknikisht, të shmangen operimet me makineri të rënda gjatë orëve të mbrëmjes në mënyrë që të minimizohet zhurma.
Shëndeti dhe Popullsia: Ndotja e ujit, ajrit, tokës dhe kushtet jo të duhura të mjedisit ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenjen e popullatës një ndër problem tjetër është edhe ethet hemorragjike që shkaktohen nga pickimi i rriqërave.	Masa zbutëse për Shëndetin e popullatës: - Gjatë zbatimit të aktivitetetve të lejuara do të përdoret sistemi i ujitjes për të minimizuar sasinë e pluhurit të liruar në mjedisin e brendshëm. Mbeturinave do të largohen në mënyrë të rregullt nga punëtorët, si dhe vendbanimet që nuk kanë ende qasje në systemin komunal për mbledhjen e mbeturinave të përfshihen sa më shpejt. - I tërë materiali ndërtues, duhet të mirëmbahet sipas standardeve për ruajtje e mjedisit. - Mbyllja e deponive ilegale.
Rreziku nga erozion: Kullotja e pa kontrolluar, lëvrimi i livadheve, prerja e pyjeve.	Masa zbutëse për erozion: - Për parandalimin e erozionit duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020. - Në kuadër të veprimeve të nevojshme duhet

	të përfshihen edhe masat hidroteknike dhe masat për menaxhimin e tokës, me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga erozioni, duhet të mirren këto masa agroteknike: - Kufizimin ose shfrytëzimin e kullotave duke përcaktuar llojin, kohën, numrin e kafshëve që mund të kullosin, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre. - Ndalimin e largimit të shtresës humusore ose shtresës së punueshme nga toka bujqësore. Detyrimin e mbjelljes së barit të llojit të veçantë në tokat e pjerrëta. - Obligimin e ndërmarrjes së masave mbrojtëse për parandalimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga erërat. - Kultivimi i brezave mbrojtës bujqësor apo mbjellja e bimëve drunore shumë vjeqare.
Zjarri: Ndezja e zjarrëve pa leje nga autoritetet komunale-shtetërore. Ndezja e zjarreve ne afërsi te vendeve ku bëhet magazinimi i kashtës/sanës për bagëti.	Masa zbutëse për Zjarrin: - Infrastruktura blegtorale e lejuar duhet të plotësojë kriteret për mbrojtje nga rreziku i zjarrit. - Duhet vendoset rrjeti i hidrantit për shuarjen e zjarri, paisjet për zjarrfikje duhet të vendosen në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë. - Kujdes i vecantë duhet kushtuar depove për ruajtjen e sanës dhe ushqimeve tjera të kafshëve të cilat gjatë temperaturave të larta janë lehtë të ndizshme.

Rekomandime për Zonën Bujqësore:

- Për të parandalur ndotjen e tokës bujqësore nga mbeturinat rekomandohet: Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave (grumbullimi i mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe zgjerimi i mundësive të riciklimit të mbeturinave).
- Ngritja e vetëdijes mjedisore mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës bujqësore dhe nxitja e pjesëmarrjesshoqërore në vendimmarrjen mjedisore.

7.2 ZONA PYJORE

Një ekosistem pyjor është një njësi funksionale ose një sistem i cili përfshin tokën, pemët, insektet, kafshët, zogjtë dhe njeriun si njësitë e tij ndërvepruese. Një pyll është një ekosistem i madh dhe kompleks dhe kështu ka diversitet më të madh të specieve. Pyjet, po ashtu janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së Dioksidit të Karbonit (CO₂) në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me Oksigjen (O₂). Janë resurse natyrore të ripertritshme, produktet e te cilit mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet stabilizojnë tokën, parandalojnë erozionin, rrisin kapacitetin e tokës për të ruajtur ujin dhe moderojnë temperaturat e ajrit dhe tokës.

Në Komunë e Malishevës zonë me rëndësi të madhe është Zona Pyjore e cila kërkon çasje të drejtë dhe menaxhim të qëndrueshëm të saj duke pasur parasyshë rëndësinë jetike për shëndet dhe të mirat materiale, rekreative, shëndetësore dhe turistike që ofron kjo zonë.

Sipas shfrytëzimit të tokës së PZHK-së, sipërfaqet pyjore shtrihen në:

- Në pjesët tjera të komunës së Malishevës me një sipërfaqe totale prej 13009 ha.
- Zonën e Interesit të Vecantë (ZIV)-Shtabi i Përgjithshëm i UCK-së Kleqkë dhe Divijakë me një sipërfaqe prej 1077 ha (ose 82.6% e sipërfaqes totale të pyjeve që gjenden brenda komunës së Malishevës)
- Në Monument të Natyrës (MN) me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës” me një sipërfaqe prej 193.8 ha (ose 92.8 % e sipërfaqes pyjore që i gjendet brenda komunës së Malishevës).

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Pyjore - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Ndikimi në Komponentën Mjedisore Zona Pyjore	Rekomandime
Ndikimet në Tokë Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i ndërtimeve të objekteve të reja turistike, rekreative, villa me sistem jo adekuat të	Masat Zbutëse për Tokën - Të zbatohen parimet e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit; - Largimi i deponive ilegale të mbeturinave të

trajtimit të ujërave të zeza, pa lokacion të mbeturinave, prerja e drunjëve, zjarret, përdorimi i pesticideve, gjatë kryerjes së punëve ndërtimore, transportit të materialeve, përdorimit të makinerive etj.	krijuara gjatë zhvillimit të aktiviteteve të lejuara; - Caktimi i lokacioni për mbeturina; - Transportimi i mbeturinave të forta në vendin përkatës të caktuar nga komuna; - Gjatë punëve ndërtimore të lejuara, ndërrimi i vajrave të makinerive punuese-transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik; - Rekomandohet që të gjitha këto aktivitetet të lejuara ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Leja Mjedisore, të identifikohen mundësitë për minimizimin e efekteve negative në mjedis;
Ndikimet në Ajër Shtëpitë malore, hotele, ndërtesat mbështetëse, infrastruktura blegtorale, shtigjet për ecje, etj.	Masat Zbutëse për Ajër - Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishtme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore, ndalimi i përdorimit të thëngjillit dhe drunjeve për ngrohje; - Reduktimi i ndotjes së ajrit duke përdorur konvertorë katalitik për automjetet e vjetra;
Ndikimet në Ujë Sistem jo adekuat të trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimi jo i duhur i mbeturinave ndërtuese, si dhe gjatë transportit të materialit ndërtues (vajra lubrifikant, karburant) nga mjetet transportuese.	Masat Zbutëse për Ujin - Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH; - Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna. - Ndërrimi i vajrave të makinerive transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik; - Të zbatohet UA-nr. 13/07 Masat mbrojtëse për burimet ujore që përdoren për pije.

Ndikimet në Biodiversitet Zhdukja e llojeve të veçanta bimore dhe shtazore karakteristike për zonën.	Masat Zbutëse për Biodiversitetin - Grumbullimi i bimëve pyjore të kontrollohet dhe të bëhet sipas standardeve europiane; - Ndalohet vjelja, mbledhja dhe shkatërrimi, prerja ose shkulja e bimëve dhe kërpudhave të cilat janë të mbrojtura me ligj; - Ndalohet tregtia me llojet e bimëve strikt të mbrojtura të cilat mbijë vetë dhe janë në listën e kuqe të Florës së Kosovës; - Të kontrollohet gjuetia e llojeve të veçanta dhe të mbrojtura me ligj; - Kafshët strikt të mbrojtura që lirshëm jetojnë në natyrë ndalohet: të merren nga natyra, të vriten me qëllim, të dëmtohen /ose shkatërrohen me qëllim format e zhvillimit, çerdhet ose strofkat si dhe zonat e shumëzimit dhe pushimit të tyre; - Ndalohet të shqetësohen gjatë kohës së shumëzimit, rritjes së të vegjërlve, migrimit dhe dimërimit; - Ndalohet përdorimi i mjeteve për kapjen dhe vrasjen e llojeve të egra si dhe shfrytëzimi i të gjitha mjeteve të cilat mundin me shkak të zhdukjen lokale ose shqetësime serioze të populacioneve në pyje. - Të kontrollohet shfrytëzimi i mineraleve; - Të kontrollohet peshkimi; - Ndalohet peshkimi i llojeve të veçanta të peshqve dhe të rrezikuar për tu zhdukur.
Ndikimet në Peizazh Sipërfaqja ku do të kryhen aktivitetet e lejuar është e vogël, dhe kjo mund të ndikoj në shkallë mikrosistemi. Peizazhi lokal do të ndryshohet, nga tokë pyjore në tokë të ndërtuar me objekte mbështetëse të cilat janë në funksion të prodhimtarisë pyjore.	Masat Zbutëse për Peizazhin - Për të ruajtur karakterin peizazhor të zonës, e veçmas ndikimin në komunitetin lokal, lokacioni ku lejohen shfrytëzimet e lejuara të zonës duhet të rrethohet me rrethoje të gjelbër ose me bimë të kultivueshme gardh natyror (bli dhe pisha dekorative) ose bimë karakteristike të zonës pyjore.

Mbeturinat Ndikime negative mund të paraqiten nëse nuk menaxhohen si duhet mbeturinat e shkaktuara nga aktivitetet e lejuara sipas Hartes Zonale.	Masat Zbutëse për Mbeturinat - Evitimi dhe reduktimi sa më i madh i mundshëm i gjenerimit të mbeturinave; - Riperdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; - Të caktohet lokacioni për mbeturina; - Zgjerimi i mundësive për riciklimit të mbeturinave; - Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave; - Mbeturinat e forta duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; - Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme; - Të zbatohet UA-nr.15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave; - Të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese; - Të zbatohet UA-nr. 06/2018 Për ndeshkimet me gjoba mandatore;
Ndikimet që shkaktojnë Zhurmën Ndotja akustike është dukuri prezente si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda, nga kryerja e punëve ndërtimore ose montuese të lejuara sipas HZK-së.	Masat Zbutëse për Zhurmën - Niveli i zhurmës duhet të jetë nën kufijtë e standardit dhe gjatë punës nuk duhet të kalon 40 Db sipas standardeve ndërkombëtare dhe dispozitave ligjore që tani janë në fuqi; Makineritë me të cilat operohet për transport, të jenë të kontrolluara teknikisht; - Të shmangen operimet me makineri të rënda gjatë orëve të mbrëmjes;
Ndikimet në Shëndetin e Popullatës Ndotja e ajrit, ujit, tokës, ndotja me mbeturina.	Masat Zbutëse për Shëndetin e Popullatës - Gjatë realizimit të aktiviteteve të lejuara duhet të përdoret sistemi i ujitjes për të minimizuar sasinë e pluhurit të liruar në mjedis. I tërë materiali ndërtues, duhet të mirëmbahet sipas standardeve për ruajtje e mjedisit - Mbeturinat e gjeneruara duhet të largohen në mënyrë të rregullt nga punëtorët;

Ndikimet në Faktorët Klimatik Energja e prodhuar nga thëngjilli, shfrytëzimi i produkteve, mbeturinat, bujqësia dhe shfrytëzimi i tokës.	Masat Zbutëse për Faktorët Klimatik - Mbrojtjen nga përmbytjet, thatësitat, menaxhimin e pyjeve dhe biodiversitetit, menaxhimin dhe shkëmbimin e informatave, ngritjen e kapaciteteve, trajnime dhe ngritjen e vetëdijes; - Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2010-2018; - Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER) 2011 – 2020; - Rindërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të ngrohjes qendrore;
Ndikimet në Erozion Prereja e drunjëve, djegja e pyjeve, ndërtimi i pa rregullt, zhvillimi i infrastrukturës	Masat Zbutëse nga Erozioni - Të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020; - Kufizimin ose ndalimin e prerjes së drunjëve, përveç në rastet kur është masë agroteknike. - Ndalimin e largimit të shtresës humusore;
Ndikimet që shkaktojnë Zjarrit Si rezultati ndikimit antropogjene, mirëpo mund të shkaktohen edhe nga faktorët natyrorë.	Masat Zbutëse nga Zjarri - Të ndërtimet e reja të vendosen hidrantët për shuarjen e zjarrit. - Pajisje për zjarrfikje duhet të vendosen në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë.

7.3 ZONË BANIMI

Sipas HZK-së zona e banimit është ndarë në 4 nën – zona, si më poshtë:

1. Nën – zona e banimit ZB-1: Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët.
2. Nën – zona e banimit ZB-2: Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë;
3. Nën – zona e banimit ZB-3: Sipërfaqet sub-urbane;
4. Nën – zona e banimit ZB-4: Sipërfaqe e përgjithshme urbane.




Figure 3. Harta e zones se banimit

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës së Banimit - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Veprimi që shkakton ndikimin Zona e Banimit	Rekomandime
Ndikimi në Tokë Në zonat rurale do të jetë shumë i kufizuar, megjithatë, disa derdhje dhe rrjedhje të karburantit, vajrave, bojës etj. janë të mundshme; duhet patur kujdes ndikime mund të ketë edhe nga shfrytëzimet e lejuara siç janë: projektet e shtallave, gropat e sillosit, objektet për ruajtjen e bylmetit dhe objektet për depozitimin e e plehut, shtëpi malore, pishina, ristorante, hapësira të vogla për riparim të automjeteve, etj. Ndërtimi i objekteve pa leje ndërtimore, ndërtimi i fermave të vogla. Në zonat urbane të mundshme janë derdhje dhe rrjedhje të karburantit, vajrave, bojës, detergjentve, etj. Ndikime mund të ketë edhe nga shfrytëzimet e lejuara siç janë: hapësira për riparim të automjeteve, autolarje, automekanik, parking, saldues, pompë të derivative, shërbimet tregtare, bankare, fetare etj.	Masat zbutëse për Tokën - Ndërtimi i objekteve pa leje ndërtimore të trajtohen në bazë të ligjit Nr. 06/L-024 për trajtimin ndërtimeve pa leje. - Pastrimin e rregullt të zonës punuese, rrugëve, banimeve, automjeteve dhe makinerive, si dhe spërkatjen me ujë të vendpunishteve dhe/ose të mbrohet nga era (p.sh. përmes mbrojtësve të erës); - Vendpunishtja duhet të zërë vetëm sipërfaqet e nevojshme për kryerjen e punimeve. - Terreni në vendin e punës duhet të restaurohet - rikthehet në gjendjen e mëparshme, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë do të rehabilitohet në mënyrë adekuate. - Gjatë planifikimit për ndërtim të objekteve si: autoservis, autolarje, hotele, restaurante, etj, rekomandohet që të gjitha këto aktivitete ti nënshtrohen procesit të VNM, LMK, Pëlqimi Mjedisor në menyrë që të minimalizohet degradimi i mjedisit.
Ndikimi në Ajër Ndikime e theksuara në ndotjen e ajrit në zonën rurale, potenciali për ndotjen e kualitetit të ajrit është minimal. Nuk janë parashikuar ndikime të theksuara në ajër, një shkallë e vogël është e mundur nga punët e	Masat zbutëse për Tokën - Emetimet e pluhurit duhet të kufizohen; - Monitorimi i cilësisë së ajrit; - Vendet e ndërtimit, rrugët e transportit dhe vendet e trajtimit të materialeve duhet të spërkatën me ujë në ditë të thata dhe me

ndërtimit, lirimi i grimcave të pluhurit në ajër, nga përdorimi i drunjëve dhe thëngjillit për ngrohje etj. Ndikime e theksuara në ndotjen e ajrit në zonën urbane, është e mundur nga punët e ndërtimit, lirimi i grimcave të pluhurit në ajër, transporti, përdorimi i lëndëve për djegje gjatë stinë së dimrit (dru, thëngjill), mungesa e gjelbërimit, mungesa e parqeve rekreative etj.	erë; - Materialet e ndërtimit duhet të ruhen në vende të përshtatshme të mbuluara për të minimizuar pluhurin; - Ngarkesat e automjeteve që kanë gjasa të lëshojnë pluhur duhet të mbulohen; - Rrugët fshihen dhe pastrohen rregullisht në pika kritike; - Të sigurohet që të makineritë dhe automjetet e transportit janë pajisur me pajisjet e duhura të kontrollit të emetimeve, mirëmbahen rregullisht dhe provohen. - Nuk duhet të ketë lëvizje të tepruar të automjeteve ndërtimore në vendpunishte.
Ndikimi në Ujë Nuk janë parashikuar ndikime të theksuara në ujë, një shkallë e vogël është e mundur nga derdhjet e kufizuara të lëngjeve të rrezikshme; nëse nuk trajtohen mbeturinat si duhet; nga projektet e shtallave (fermave të vogla dhe të mesme); objektet për depozitimin e plehut etj. Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktivitetet e fermave mund të ndikohet në disa rrugë: Menaxhimi jo adekuat i plehut dhe urinës së kafshëve mund të rezultojë me depërtimin deri në ujërat nëntokësore, në veçanti kjo mund të jetë e dëmshme në rast të fermave me kapacitete të mëdha, dhe në rast se në afërsi ka zona nga ku përdoret uji për pije (qoftë ujëra sipërfaqësor, qoftë puse).	Masat zbutëse për Ujë - Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH; - Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna. - Ndërrimi i vajrave të makinerive transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik; - Të zbatohet UA-nr. 13/07 Masat mbrojtëse për burimet ujore që përdoren për pije.
Mbeturinat Ndikime negative mund të paraqiten nëse nuk menaxhohen si duhet mbeturinat e shkaktuara nga aktivitetet e lejuara sipas Hartes Zonale.	Masat Zbutëse për Mbeturinat - Evitimi dhe reduktimi sa më i madh i mundshëm i gjenerimit të mbeturinave; - Ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; - Të caktohet lokacioni për mbeturina; - Zgjerimi i mundësive për riciklimit të

	mbeturinave; - Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave; - Mbeturinat e forta duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; - Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme; - Të zbatohet UA-nr.15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave; - Të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese; - Të zbatohet UA-nr. 06/2018 Për ndeshkimet me gjoba mandatore;
Ndikimi në Biodiversitet: Janë parashikuar ndikime në natyrë sa i përket ndërtimeve të reja si objekte të banimit, infrastruktura rrugore, shfrytëzimi për prodhim bujqësor (shtallë për kafshë) etj. Sa i përket zonave të mbrojtura nuk është parashikuar ndikim pasi që nuk do të bëhen punime në zonat e mbrojtura dhe punimet janë punime të kufizuara ndërtimore.	Masat zbutëse për Biodiversitet: - Për ndikimet e theksuara në florë dhe faunë rekomandohet projektet ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, dhe të zbatohen masat për ruajtjen e tyre. - Shfrytëzimet e lejuara sipas HZK, rekomandohet të iu nënshtrohen prodedurës së LMK-së, VNM-së, Pëlqim Mjedisor, Leje Mjedisore në mënyrë që të minimalizohen ndikimet negative në natyrë.

7.4 ZONA EKONOMIKE INDUSTRIALE DHE ZONA KOMERCIALE

Mjedisi është tërësia e gjërave që ndodhen rreth nesh, me të cilat direkt apo indirekt është e lidhur jeta dhe veprimtaria e njeriut. Njeriu dhe mjedisi janë binom që ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë të njëri-tjetri. Veprimtaritë njerëzore, zhvillimi i shpejtë i teknikës dhe industrisë si dhe shtrirja globale në tërë planetin kanë shkaktuar çrregullime të mëdha mjedisore dhe prishje ekuilibri. Si rezultat i rritjes së popullsisë, nevoja për konsum jetik është rritur ndjeshëm, gjithashtu dhe prodhimi industrial. Zhvillimi i teknologjisë, industrializimi i shpejtë i bujqësisë, zgjerimi i industrisë kimike, dhe nevoja për të krijuar forma të lira të energjisë, përveç prodhimit primar kanë shkaktuar lëshimin e vazhdueshëm të përbërjeve organike, inorganike, mbetjeve të lëngëta, të gazta dhe të ngurta në mjedisin rrethues, duke shkaktuar kështu efekte negative në ekosisteme dhe njerëz. Zona industriale përfshinë sipërfaqet e caktuara për zhvillimin e ndërtesave për prodhimtari industriale. Zona ekonomike është e përcaktuar me PZHK dhe ofron hapësirë për zhvillim të industrisë për prodhim të lëndës së parë dhe prodhimeve të lehta si dhe shërbimeve për prodhim tretësor. Për më shumë, zona do të ofrojë edhe hapësirë për zhvillime tjera të cilat janë në shërbim të zonës. Hapësira është lokalizuar me PZHK në lokacinet Banjë, Bellanicë dhe Senik dhe në planin e veprimet është përcaktuar zhvillimi i studimit të fizibiliteti për zhvillimin e industrisë ekstraktuese minerale. Vendimi nga Kuvendi i Komunës me datë.

Zona është e planifikuar për zhvillim komercial dhe do të zhvillohet në lokacionet e përcaktuara me PZHK. Zona ofron hapësirë për zhvillim të veprimtarive komerciale në të cilat mund të përfshihet edhe industri e prodhimeve të lehta si dhe shërbimeve për prodhim tretësor. Për më shumë, zona do të ofrojë edhe hapësirë për zhvillime tjera të cilat janë në shërbim të zonës.




Figure 4 Harta e Zones Komerciale dhe Industriale

Ndikimi në Komponentën Mjedisore:

Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i ndërtimeve të objekteve industriale dhe zhvillimit të aktiviteteve të tyre, ndotja e ajrit ndikohet nga pluhuri i liruar gjatë ndërtimeve të reja, sasia e mbeturinave të gjeneruara, energjia e cila përdoret për ngrohje.

Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ndërtuese, gjatë transportit të materialit ndërtues, dhe nga trajtimi jo i duhur i ujërave të zeza në zonë.

Proceset industriale në Zonën Industriale përveçse prodhimit primar prodhojnë dhe produkte sekondare, mbetje të ngurta, të lëngëta dhe të gazta, në mjedisin rrethues për të cilat duhet të ketë kontroll dhe monitorim të vazhdueshëm.

Ndikimet direkte ndodhin si rezultat i ndryshimeve fizike të vecorive të peizazhit ndersa ndikimet indirekte mund të ndodhin si rezultat i ndërhyrjes pamore që ndikon në karakterin e peizazhit.

Ndotja akustike është dukuri prezente si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda, makinave, mjetet transportuese, paisjet e ndryshme dhe aparaturat e ndryshme.

Prodhimi i metaleve bazike, metaleve të fabrikuar, prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës, shërbimet tregtare si automekanik dhe autolarje.

Shfrytëzimet e lejuara si dytësore: trafo të rrymës, kaldaia, infrastruktura e prodhimeve të rënda, infrastruktura e telekomunikacionit. Të gjitha këto të përmendura më lartë ndikojnë negativisht në mjedis.

Masat Zbutëse:

- Bazuar në kornizën ligjore në lidhje me Udhëzimin Administrativ MMPH/01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, Shtojca/Lista e aktiviteteve për të cilat duhet të merret leja mjedisore komunale, aktivitetet në kuadër të Zonës Industriale bie në fushëveprimin e UA-së/MMPH/01/2017 të përmendur më sipër;
- Në zonën Komeriale mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe pasuritë kombëtare të Kosovës dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Të zbatohen masat për mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit sipas Planit Lokal për Cilësi të Ajrit 2020-2024;
- Të zbatohen masat sipas Strategjisë për Cilësinë e Ajrit, 2013-2022 MMPH tani (MEA);
- Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH;
- Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna;
- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve mjedisor në zonat e mbrojtura;
- Të gjitha aktivitetet në zonën industriale në mënyrë që të parandalohet ndotja duhet të rrethohen me breza të gjelbër mbrojtës me gjerësi minimale 5m;
- Mbeturinat ndërtimore duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna;
- Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Të zbatohet UA-nr.15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave; Të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese;
- Menaxhimi i mbeturinave të ndërtimit;

- Strategji për përdorimin e materialit për ndërtim dhe riciklimin e materialeve të përdorura të ndërtimit;
- Mbështetja e riciklimit të mbeturinave me subvencione;
- Me masat e mbrojtjes nga zhurma, patjetër duhet të pengohet paraqitja e zhurmës, respektivisht të zvogëlohet zhurma në nivel optimal;
- Masat e mbrojtjes nga zhurma përmbajnë:
 - Përzgjedhjen dhe përdorimin e makinave, pajisjeve, mjeteve të punës dhe të transportit të cilat nuk shkaktojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar;
 - Vendosjen e objekteve me burim zhurme dhe zonat të cilat duhet mbrojtur nga zhurma;
 - Izolimin për mbrojtjen nga zhurma të ndërtesave të cilat mund të jenë si burim i zhurmës në hapësirat e punës ose banimit;
 - Matjet me qëllim të përcjelljeve dhe mbikqyrjes së përhershme të zhurmës;
 - Kufizimet e herë pas herëshme të emitimit të zhurmës;
 - Mbrojtja nga zhurma aplikohet ditën, mbrëmjen dhe natën. Ndërtesa duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar në mënyrë që zhurma të cilën e degjojnë njerëzit që banojnë në afërsi të jetë e atij intenziteti që nuk do ta rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për punë;
- Metalet nuk duhet të depertojnë në tokë, ujë pasi mund të shkaktojnë ndotje të rëndë;
- Të ndalohet ndërtimi i objekteve industriale në afërsi të zonës së banimit, distanca duhet të jetë së paku 1000 m;
- Ndalohet ndërtimi i çerdheve dhe shkollave në afërsi të zonës industriale;
- Të bëhen hulumtime më të detajuara për ndikimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në shëndetin publik;
- Aktivitetet në zonën Komerciale dhe Industriale domosdoshmërisht duhet të parandalojnë ose, kur kjo nuk është e zbatueshme, të reduktojnë deri në minimum të ndikimit të përgjithshëm të emisioneve në mjedis dhe të rrezikimit të mjedisit dhe shëndetit të njeriut;
- Aktivitetet në zonën Komerciale dhe Industriale: Të zhvillojnë veprimtaritë në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

7.5 ZONA TURISTIKE & REKREATIVE

Zona rekreative–turistike përfshin në vete një numër të madh të monumenteve me rëndësi të trashëgimisë natyrore dhe kulturore që së bashku me elementet tjera të natyrës krijojnë një peisazh tërheqës për vizitorët. Në kuadër të kësaj zone përfshihen pjesë nga territori i Monumentit Natyror, Ujëvarat e Mirushës'', në kuadër të së cilës ndodhen Zona e Veçantë e Mbrojtur “Kisha e Eremitëve” në fshatin Ularicë, shpellat Kisha e Madhe dhe e Vogël dhe Shpella në Shpirtra, liqenet e vogla. Kjo zonë pastaj ndërlidhet me Korridorin e gjelbër dhe përfundon me Monumentin Natyror hidrografik, “Burimi termal” në Banjë, më pas vazhdon me pjesë të “Zonës e interesit të Veçantë, Kleçkë dhe Divjakë”, tokën pyjore e bujqësore si dhe monumentet arkeologjike e kulturore. Në këtë zonë planifikohet të zhvillohet turizmi ekstenziv dhe i rekreacionit duke bërë bashkë peisazhin natyror dhe ofertën cilësore turistike. Zona është e përshtatshme për zhvillimin e turizmit vikendor, rehabilitues, malor, rural, kulturor dhe ekoturizmit.




Figure 5. Harta e zonës turistike dhe rekreative.

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Rekreative - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Veprimi që shkakton ndikimin Zona Turistike & Rekreative	Rekomandime
Ndikimet në Tokë Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i ndërtimeve të objekteve turistike si: Hotele, Bujtina, shtëpiza të banimit, depo, garazha, kampingjet etj pastaj i objekteve të ndryshme; markete, trafika, etj	Masat Zbutëse për Tokën - Rekomandohet që të gjitha këto aktivitetet të lejuara ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të identifikohen mundësitë për minimizimin e efekteve negative në mjedis. - Krijimi i rrjetit të shtigjeve, - Përdorimi i materialeve autoktone dhe miqësore ndaj mjedisit; - Ndërtimi i objekteve turistike behët vetëm në parcelat të caktuara nga komuna.
Ndikimet në Ajër Ndotja e ajrit ndikohet nga pluhuri i liruar gjatë ndërtimeve të reja, sasia e mbeturinave të gjeneruara, energjia e cila përdoret për ngrohje.	Masat Zbutëse për Ajër - Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore, ndalimi i përdorimit të thëngjillit dhe drurit për ngrohje; - Reduktimi i ndotjes së ajrit duke përdorur konvertorë katalitik për automjetet e vjetra; - Të zbatohen masat për mbrojtjen e Cilësisë së Ajri sipas legjislacionet dhe udhëzimeve të republikës së Kosovës.
Ndikimet në Ujë Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ndërtuese, gjatë transportit të materialit	Masat Zbutëse për Ujin - Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH;

ndërtues, dhe nga trajtimi jo i duhur i ujërave të zeza në zonë.	- Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; - Ndërrimi i vajrave të makinerive transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik;
Ndikimet në Biodiversitet Aktiviteti antropogjen; Shkatërrimi permanent i mjediseve natyrore; Degradimi/pakësimi; Biodiversiteti humb gjatë ndërtimit; Migrimi i popullsisë së kafshëve si shkak i shqetësimit; Krijimi i mjediseve të reja për llojet e kafshëve dyndese/pushtuese.	Masat Zbutëse për Tokën - Të pengohet shfrytëzimi i tepërt, rrezikimi i llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimet e tyre; - Parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike dhe rekreative; - Mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së; - Ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve të cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre);
Ndikimet në Peizazh Zbatimi jo i plotë i masave mbrojtëse për trashëgiminë. Ndërtimi i hoteleve, restauranteve, kioska, ndërtimi i rrugës përgjatë zonës turistike, etj. Mungesa e promovimit të trashëgimisë natyrore.	Masat Zbutëse për ndikimet në Peizazh - Ndikimet në karakterin e peisazhit mund të ndodhin në ato zona karakteristike që ndikohen direkt ose indirekt nga propozimet. - Ndikimet direkte ndodhin si rezultat i ndryshimeve fizike të veçorive të peisazhit, ndërsa ndikimet indirekte mund të ndodhin si rezultat i ndërhyrjes së jashtme që ndikon në karakterin e peisazhit apo në pozicionimin e tipareve të peisazhit. Pra shtrirja fizike mbi të cilën

	ndodh ndikimi do të varet nga vlerësimi i karakteristik bazë dhe nga shtrirja e punimeve të propozuara. - Ndikimet do të jenë të përkohshme ose të përhershme. - Studimi dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë natyrore - Studimi dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore - Joshja e vizitorëve - Bashkëpunimi ndër-komunal. - Ndalohet ndërtimi i objekteve në zona të mbrojtura pasi që mund të shkaktojnë degradim të ambientit.
Mbeturinat Ndikime negative mund të paraqiten nëse nuk menaxhohen si duhet mbeturinat e shkaktuara nga aktivitetet e lejuara sipas Hartes Zonale. Ndikimet negative nga faktori antropogjen duke ndotur mjedisin.	Masat Zbutëse për Mbeturina - Ngritja e vetdijës që personi i cili zhvillon aktivitetet që ndikojnë në shtimin e sasisë së mbeturinave bartin përgjegjësi për mbeturinat e krijuara gjatë aktiviteteteve të tyre; - Caktimi i lokacioni për mbeturina dhe zgjerimi i mundësive për riciklimit të mbeturinave; - Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave; - Mbeturinat e forta duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; - Nuk lejohet krijimi i deponive ilegale; - Të zbatohen udhëzimet administrative dhe rregulloret shtetërore për menxhim dhe trajtim të mbeturinave.
Ndikimet që shkaktojnë Zhurmën Me rastin e plotësimit të aktivitetetve rekreative, organizimit të aktiviteteve argëtuese, sportive dhe tjera për banorët vendor ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësitë e tejkalimit të nivelit	Masat Zbutëse për Zhurmën - Me masat e mbrojtjes nga zhurma, patjetër duhet të pengohet paraqitja e zhurmës, respektivisht të zvogëlohet zhurma në nivel optimal; - Masat e mbrojtjes nga zhurma

të zhurmës së lejuar, njesitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë lokacion të përshtatshëm për qëllime të tilla brenda zonës.	përmbajnë: - Përzgjedhjen dhe përdorimin e makinave, pajisjeve, mjeteve të punës dhe të transportit të cilat nuk shkaktojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar; - Vendosjen e objekteve me burim zhurme dhe zonat të cilat duhet mbrojtur nga zhurma; - Izolimin për mbrojtjen nga zhurma të ndërtesave të cilat mund të jenë si burim i zhurmës në hapësirat e punës ose banimit; - Matjet me qëllim të përcjelljeve dhe mbikqyrjes së përhershme të zhurmës; - Kufizimet e herë pas hershme të emitimit të zhurmës; - Mbrojtja nga zhurma aplikohet ditën, mbrëmjen dhe natën. - Ndërtesa duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar në mënyrë që zhurma të cilën e degjojnë njerëzit që banojnë në afërsi të jetë e atij intenziteti që nuk do të rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për punë;
Ndikimet në Shëndetin e popullatës Ndotja e ajrit, ujit, tokës, ndotja me mbeturina, rreziki i shëndetit të popullatës nga ethet hemorragjike.	Masat Zbutëse për Shëndetin e popullatës - Në zonën rekreative sipas hartës Zonale nuk parashihen ndikime të theksuara, të dëmshme në shëndetin e popullatës.
Ndikimet në Erozion Prereja e drunjëve, ndërtimi i pa rregullt, zhvillimi i infrastrukturës.	Masat Zbutëse për Erozionin - Të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020; - Kufizimin ose ndalimin e prerjes së drunjëve, përveç në rastet kur është masë agroteknike.

	- Ndalimin e largimit të shtresës humusore;
Ndikimet që shkaktojnë Zjarrin Si rezultati ndikimit antropogjene, mirëpo ka potencial edhe nga faktorët natyrorë.	Masat Zbutëse për Zjarrin - Të vendosen hidrantët për shuarjen e zjarrit. Pajisje për zjarrfikje duhet të vendosen në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë.

cilat shkaktajnë erozion të sipërfaqes së deponive si dhe të shkarkimit të ujërave të kontaminuara nëntokësor në sipërfaqe. Kontaminimin e ajrit nga retë e pluhurit nga deponitë gjatë erërave në periudhat me mot të thatë. Kontaminimi i tokës bujqësore nga deponimi i pluhurit të depozituar nga deponitë e mbyllura. Kontaminimi i hapësirave të banimit, rrugëve dhe shesheve publike nga deponimi i pluhurit. Degradim i florës dhe faunës.	legjislacionit mbështetës; – Zbatimi i strategjisë minerare 2010-2025; – Rehabilitimi i lokacioneve të deponive; – Rehabilitimi i tokave bujqësore, dhe – Fushatat e vetëdijesimit. – Përveç kësaj, programet për përmirësimin e tokës bujqësore janë më së të nevojshme sa më parë. – Vlerësimi dhe studimi i ndikimit në biodiversitetit përpara lëshimit të lejes për punime. – Monitorimi i cilësisë së ajrit. – Pajisja e punëtoreve me rrobat mbrojtëse (doreza, kapela të forta) dhe pajisje gjatë gjithë kohës.
---	--

7.7 SIPËRFAQET E UJORE DHE ZONAT E MBROJTURA SANITARE UJORE

Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj. Qëllimi i ligjit për mbrojtjen e ujërave është të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social – ekonomik, si dhe të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi. Ujërat nuk janë lëndë e së drejtës së pronësisë të personave fizikë dhe juridikë, pa dallim nga statusi juridik i pronës në të cilën gjenden. Nxjerrja, shfrytëzimi, akumulimi, ndryshimi i drejtimit, ndërtimi, lëshimi si dhe veprimet tjera ndaj ujërave, duhet të kryhen në kushte, në mënyra dhe në procedura të përcaktuara me ligjin nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës.

Në komunën e Malishevës, sipërfaqet ujore i referohen pasurive ujore si: Ujërat sipërfaqësorë:

- Lumi Mirusha së bashku me Ujëvarat e Mirushës të cilat mbajnë status të vlerave natyrore;

Ujërat nëntokësorë:

- Burimet e ujit që shfrytëzohen për furnizim publik me ujë të pijshëm (kapacitetet më të mëdha furnizuese vijnë prej Senikut dhe Banjës dhe tjerat nga dy burime në fshatin Gurbardh, Panorc dhe Javiq dhe rrjedha Belak në Maxharrë).
- Burimet termomineralike (në Banjë dhe Bjeshkët e Berishës).




Figure 7. Harta e zonës së sipërfaqeve ujore

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Sipërfaqëve Ujore dhe Zonat e Mbrojtura Sanitare Ujore - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Veprimi që shkakton ndikimin në Zona Sipërfaqëve Ujore & Zonat e Mbrojtura Sanitare Ujore	Rekomandime
Ndikimet në Komponentën Mjedisore Aktivitetet e ndërtimi, ndërtimi i urave, rrugëve dhe hekurudhave. Mbetjet e ngurta dhe të lëngshme nga kampi i punëtorëve dhe aktivitetet e ndërtimit të urave, rrugëve dhe hekurudhave. Karburanti i makinerive, rrjedhje e	Masat Zbutëse - Shmangia e vendeve të punës afër rrjedhave ujore; Puna e ndërtimit gjatë sezonit të thatë dhe jashtë sezonit të celjes së zogjve; - Të riparohen mjediset pasi të mbarojë puna;

lubrifikanteve. Aksidentet (karburant lubrifikante, mbetjet e rrezikshme), zhurma në faunë, pluhuri. Shkatërrimi dhe degradimi i mjediseve. Largimi/levizja i/e faunës. Dëmtimi ose shkatërrimi i vendeve shtuese për peshk dhe lloje të ndryshme, peshkimi i pa kontrolluar. Furnizimi me materiale inerte. Gjuetia- pakesimi i specieve dhe abondanca e tyre. Migrimi i popullsisë së kafshëve si pasojë e shqetësimit. Ekziston mundësia për ndotjen e ujrave nëntokësore nga derdhjet aksidentale të gazrave dhe karburanteve. Faktori antropogjen, për përfitime personale.	– Shmangia e punimeve në shtratin e lumit; Mbledhja dhe riciklimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngeshme në vendin e punës; – Masa për të shmangur rrjedhjen aksidentale të lubrifikanteve dhe karburanteve; – Mbledhja dhe riciklimi i lubrifikantëve, punët e ndërtimit gjatë sezonit të thatë; – Ndërtimi i një sistemi të duhur drenazhi/kullimi për tepricen e ujit; – Mbledhje dhe riciklim i mënjëherëshëm i mbeturinave; – Ndalohet larja e mjeteve lundruese, mjeteve motorike dhe pajisjeve tjera në ujërat sipërfaqësorë dhe në brigje; – Minimizimi i fuqishëm i zhurmës; – Ujitja e rrugës gjatë sezonit të thatë; – Mos shfrytëzimi i materialeve inerte nga lumenjtë; – Forcimi i rregullores së gjuetisë; – Monitorimi i gjuetisë; – Parandalimi i gjuetisë së llojeve të rralla dhe të mbrojtura me ligj; – Të merren masa të përshtatshme për kontrollin e ndotjes nga derdhjet e gazrave dhe karburanteve për të zvogëluar sa me shumë impaktet; – Ndalimi i nxjerrjes së dheut, rërës, zhavorrit dhe gurit; – Ndalimi i shartimit, prerjes dhe gërmimit të drunjve dhe kaçubave; – Ndalimi i kullotjes së kafshëve; – Prerja e drujve mund të bëhet në kushte, në mënyra dhe procedura me të cilat sigurohet mbrojtja nga erozioni, si dhe në harmoni me ligjin për pyjet; – Ndalohet hudhja e substancave dhe
--	--

	– mbeturinave të ngurta, të lëngëta dhe të gazëta të cilat për shkak të vetive fizike, kimik dhe biologjike, rrezikojnë shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, florën dhe faunën ujore, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë objektet dhe pajisjet ujore; – Të zbatohet Ligji Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës; – Të zbatohet Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit; – Të zbatohet Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;
--	---

7.8 ZONA E SHËRBIMEVE

Sipas analizës së veprimeve strategjike dhe aktiviteteve të përcaktuara për zonën e shërbimeve në përgjithësi do të sjellin efekte pozitive në mjedis. Me respektimin e plotë të planit, masave për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor, ndikimet do të jenë të vogla dhe lehtë të kontrollueshme.

Ndikimet në Komponentën Mjedisore:

Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i ndërtimeve të objekteve shkollore, rekreative, turistike etj, dhe zhvillimit të aktiviteteve të tyre, ndotja e ajrit ndikohet nga pluhuri i liruar gjatë ndërtimeve të reja, krijimi i venddeponive të mbeturinave.

Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ndërtuese, gjatë transportit të materialit ndërtues.

Ndotja akustike është dukuri prezente si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda, makinave, mjetet transportuese, paisjet e ndryshme dhe aparaturat e ndryshme, nga aktivitetet e argëtimit.

Shfrytëzimet e lejuara si dytësore: shërbimet hoteliere, kthina teknike (ngrohje, ventilim, depo (p.sh. druve) e të ngjashme, hapësira për deponim dhe të ngjashme në funksion të shërbimit, trafo të rrymës, kaldaja, infrastruktura e telekomunikacionit. Të gjitha këto të përmendura më lartë ndikojnë negativisht në mjedis.

Masat Zbutëse

Rekomandohet hapësirat e hapura rekreative të vendosen: në afërsi të zonave të banimit, në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik.

Objektet e religjionit – Hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve fetare si dhe shërbimeve të tjera të lidhura nuk parasheh ndonjë ndikim të theksuar negativ në mjedis.

Ndërtesat e institucioneve parashkollore, shkolla dhe gjimnazet – paraqesin ndikim të përzier në mjedis. Ndikim pozitiv sepse ngritja e infrastrukturës shkollore dhe trajnuese do të ofrojë edhe mundësi për ngritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit. Dhe ndikim negativ për faktin se ndërtimet manifestohen me ndikime të ndryshme mjedisore sidomos në zënie të tokave, krijimin e mbeturinave apo edhe rritjen e presionit në mjedis përmes formave tjera të emetimeve. Për ndërtimin e objekteve të reja shkollore dhe ndërtimin e objekteve që

ofrojnë shërbime hoteliere duhet të ndiqet procedurat e udhëzimit administrative per LMK dhe VNM.

Institucionet e administratës publike- Me PZHK nuk është paraparë ndërtimi i objekteve të administratës publike dmth nuk paraqet ndikim negativ në mjedis.

7.9 ZONA E RRJETIT TË TRANSPORTIT

Zhvillimi i rrjetit të transportit, duhet të marrë për bazë aspektet mjedisore përmes zbatimit të parimeve të VNM- së dhe parimeve tjera të zbatueshme, dhe të jetë në përputhje të plotë me UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinorë.




Figure 8. Harta zonale e infrastrukturës rrugore

Transporti publik – Krijimi i rrjetit të transportit urban për Komunën e Malishevës parashihet ndikim pozitiv. Sa i përket mobiliteti apo lëvizshmërisë së këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve të motorizuara ato duhet të jenë të fokusuar në favorizimin e transportit publik dhe transportit të qëndrueshëm që do të mundësonte uljen e emisioneve ndotëse në ajër.

Vend parkimet publike – Të respektohen kërkesat për vend parkime përmes krijimit të rregullave në përputhje me Udhëzimin Administrativ 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor të cilat synojnë zvoglimin e ngarkesave të automjeteve dhe rreziqeve që zhvillohen nga trafiku.

Komuna e Malishevës ballafaqohet me mungesën e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave.

Rekomandime:

- Si pjesë e ndërtimit të çfarëdo rruge të re, ose ndërtese të re, duhet të kërkohet që të mbillen drunjtë përgjatë rrugëve.
- Gjatë zhvillimit të ri infrastrukturorë aty ku ka mundësi dhe potencial për biodiversitet të pasur me lloje të ndërtohen mbi-kalime të gjelbra, që kafshët të kalojnë rrugën me siguri.
- Në vendbanimet në të cilat pemët kanë një moshë mbi 100 vjeçare, të krijohen rreth rrotullime në mënyrë që të mbrohen ato.
- Të vendosen përgjatë rrugëve shpërndarës të ujit që pastrojnë rrugët dhe parandalojnë ndotjen e qytetit nga pluhuri.
- Në vendet e pjerrëta të krijohen shkallë lëvizëse për biçikleta, pasi ngjitja në kodrat e pjerrta është më e lehtë.
- Gjatë ndërtimit të rrugëve lidhëse, të ndërtohen ura me litar për të mundësuar lëvizjen e lirë të kafshëve.
- Për menaxhimin e deponive të mbeturinave, të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese, të zbatohet UA-nr. 06/2018 për ndeshkimet me gjoba.

negative në kapacitetin e burimit si dhe në vetitë natyrale të ujit të burimit caktohen zonat sanitare të mbrojtjes së burimeve të ujit (më gjerësisht për zonat sanitare referoju zonës së sipërfaqeve ujore).

Përveq Ujëvarës së Mirushës, Komuna e Malishevës është e pasur edhe me 4 monumente natyrore të tjera me karakter hidrografik:

- Burimi termal në Banjë
- Burimi Gurbardh
- Burimi i ujit në Caravranë
- Rrjedha e lumit Mirusha

Monumentet me karakter Botanik

Në komunën e Malishevës, ekzistojnë 10 monumente me karakter botanik (shih listën më lartë/faqe 35).

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës së Monumenteve Botanike - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Veprimi që shkakton ndikimin në Zonën e Monumenteve Botanike	Rekomandime
Ndikimet në Komponentën Mjedisore Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e	Masat Zbutëse – Të zbatohet Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit; – Të zbatohet Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës; – Ndalohet prerja degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve ose çfarëdo veprimtarie e cila e ndryshon gjendjen e tanishme. – Të merret leje e veçantë nga institucionet shtetërore për mbledhje të bimëve të

mbrojtur. Punimi (lëvrime, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur . Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të monumentit të natyrës. Rrjedhja (lëshimi) i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike. Ndërrimi i kulturës, mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve tjera të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së monumentit.	mbrojtura më ligj.
---	--------------------

Monumentet me karakter Gjeomorfologjik

Në komunën e Malishevës, ekzistojnë 4 monumente me karakter gjeomorfologjik (shih listën më lartë/faqe 34)

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës së Monumenteve Gjeomorfologjike

Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Veprimi që shkakton ndikimin në Zonën e Monumenteve Gjeomorfologjike	Rekomandime
Ndikimet në Komponentën Mjedisore Shfrytëzimi i gurëve nga shpella. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur, ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur. Rrjedhja (lëshimi) i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera. Përdorimi i mjeteve	Masat Zbutëse – Të zbatohet Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit; – Të zbatohet Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës; – Hyrja në shpella, eksplorimi dhe studimi i shpellave, bëhet me leje të Ministrisë e cila jepet në propozim të autoriteteve lokale përkatëse, institucioneve shkencore dhe organizatave të

mbrojtëse kimike; Ndërrimi i kulturës, mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve tjera të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së monumentit.	specializuara jofitimprurëse, në përputhje me rekomandimet e tyre. — Shpellat mund të vizitohen, të përdoren për qëllime turistike ose të tjera, vetëm pasi të jenë përshtatur për këto veprimtari, me autorizim dhe nën mbikëqyrjen e AKMM, strukturave përkatëse të turizmit dhe pushtetit lokal. Eksplorimi, hyrjet e autorizuara dhe çdo përdorim i shpellave, duhet të sigurojë mbrojtjen dhe pastërtinë e tyre, ruajtjen e mikroklimës, regjimit ujor, ekosistemeve, të tipareve gjeologjike dhe gjeomorfologjike, të gjetjeve paleontologjike e arkeologjike dhe të gjallesave.
---	--

Zonë e mbrojtur e trashëgimisë kulturore e historike (ZMTKH)

Sipas HZK-së në këtë zonë bën pjesë Zona me interes të Veçantë (ZIV) e “Shtabit të përgjithshëm të UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë” e cila shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe i takon tri komunave: Malishevë, Drenas dhe Lipjan. Kjo Zonë në komunën e Malishevës zë një sipërfaqe prej 1077 ha. Në këtë zonë janë të pranishme pyje dhe kullosa të cilat japin një pamje shumë tërheqese dhe shërbejnë si vende për strehimin e faunës. Përveç që është e pasur nga aspekti natyrorë dhe kulturor kjo zonë ka edhe rëndësi në aspektin historiko-kulturor nga lufta e fundit në Kosovë.

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës së mbrojtur të trashëgimisë kulturore historike - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Veprimi që shkakton ndikimin në Zonën e mbrojtur të trashëgimisë kulturore historike	Rekomandime
Ndikimet në Komponentën Mjedisore Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur, ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur. Ndikim negativ në mjedis pritet edhe nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e objekteve, ndërtimin e rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, hoteleve/moteleve, tezgave, etj. Ndotja me mbeturina nga ndërtimi, turizmi. Me ngritjen e këtyre objekteve do të shfrytëzohen burimet natyrore të cilat do të rrisin emetimet në mjedis, do të ndikojnë në humbjen e tokës, do të krijohen mbeturina të materialeve ndërtimore disa prej të cilave kanë veçori të rrezikshme me mundësi të ndotjes së ujit dhe dheut.	Masat Zbutëse Rekomandohet që të gjitha këto projekte që priten të realizohen ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të identifikohen mundësitë për minimizimin dhe parandalimin e efekteve negative në mjedis.

8. ZONAT MBISHTRESORE

Zona mbishtresore përcakton kushte zhvillimore dhe ndërtimore plotësuese brenda një sipërfaqeje të komunës të cilës i nevojitet vëmendje e veçantë. Zonat mbishtresore vendosen mbi një apo disa zona bazë, krahas kushteve të zonës bazë. Kushtet mbishtresore vendosin kushte apo masa plotësuese. Në rastet kur janë përcaktuar kushte që janë në kundërshtim në mes të zonës bazë dhe zonës mbishtresore atëherë kushtet e zonës mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre të zonës bazë. Zonat mbishtresore përdoren për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte dhe masa mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike ku përcaktohen:

- Masa mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;
- Masa mbrojtëse dhe parandaluese për Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;
- Masa mbrojtëse për resurset lokale natyrore, si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, etj të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;
- Masa mbrojtëse për ndikimet në mjedis, si: ndotja e ajrit, zhurmës, etj;
- Përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmbytja, sipërfaqet seizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, orteqeve, tërmetet, e të tjera, dhe
- Standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për t'u zbatuar në gjithë territorin e Komunës.

Zonë mbishtresore e ndikuar nga Vërshimet

Masat parandaluese

- Ndalimi i përdorimit të materialeve masive (nën dhe anash lumit sepse pengon drenazhimin natyral të ujit)
- Ndalimi i eksploatimit të zhavorit nga shtretërit të lumenjve
- Ndalimi i ndërtimit të kapaciteteve për prodhim të ujit, puseve, rezervuareve për ujë të pijshëm
- Ndalimi i ndërtimit të shtallve për kafshë mbi 50 krerë, pishinave për kultivimin dhe rritjen e peshkut

- Ndalimi i ndërtimit të shtëpive, pishinave dhe ndërtesave hotelerike, rrugëve dhe urave në vende që janë të rrezikuara nga vërshimet
- Ndalimi i prerjeve të pakontrolluara të pyjeve në afërsi të zonave vërshuese
- Ndalimi i veprimtarive si: varrezat e veturave, autoserviset, industritë që kanë për bazë ose që përdorin materie të lëngshme kimike, deponimi i naftës dhe derivateve të sajë, ndërtimi i rrugëve pa sistemin e largimit dhe pastrimin e ujërave atmosferike, eksploatimi i resurseve minerare, industritë ushqimore, gropat septike, deponit e mbeturinave dhe të gjitha instalimet për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave

Masat mbrojtëse

- Ruatja e shtratit natyral
- Vendosja e barrierave nga materialet miqësore në pjesët ku vërshon uji
- Gjatë ndërtimeve duhet të merren parasysh këto masa plotësuese:
- Ndërtesa duhet të jenë së paku 70cm mbi kuotën më të lartë mbidetare të vërshimeve që kanë ndodhur bazuar në hartën e rrezikshmërisë nga vërshimet
- Shfrytëzimi i hapësirave të brendshme nën këtë nivel lejohet përderisa:
- Janë të izoluara me materiale hidroizoluese të qëndrueshme
- Të zbatohen masa inxhinierike shtesë, të përshkruara në mënyrë të detajuar në dokumentacionin teknik të lejes ndërtimore dhe të testuara ndërkombëtarisht

Zonë mbishtresore e ndikuar nga Erozioni

Masat mbrojtëse:

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri,
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfëra me bimësi,
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara,
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë,
- Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes,
- Mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjve,
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve.

Zonë mbishtresore e ndikuar nga Tërmetet

Masat mbrojtëse

- hulumtimet për identifikimin e gjendjes së tokës ku do të ndërtohet,
- materialin ndërtimor,
- projektimin e strukturave,
- ndërtimin e strukturave,
- kontrollimi dhe inspektimi i cilësisë së materialeve në çdo fazë të ndërtimit.

Zonë mbishtresore e ndikuar nga Zjarret

Masat mbrojtëse

- ndalimi i piknikut,
- monitorimi i rregullt i gjendjes dhe gjobitja,
- aplikimi i masave teknike si largimi i drunjve dhe shkurreve të thara,
- parandalimi i rritjes së tepërt të shkurreve,
- kontrollimi i distancës në mes të drunjve mund të parandalojë zjarret në pyje.

Zonë mbishtresore e ndikuar nga Ethet Hemorragjike

Masat mbrojtëse

- Dezinfektimi i territorit të kontaminuar në periudhën mesi i majit-mesi i qershorit,
- Aktivitete të edukimit dhe vetëdijesimit shëndetësor të ndërmarra,
- Aktivitete të dezinfektimit selektiv.

Zonë mbishtresore e ndikuar fatkeqësitë Tekniko-teknologjike

Masat parandaluese:

- Ndalimi i ndërtimeve në afërsi deri 1000 m të pompave,
- Ndalimi i hapjes së pompave të karburantëve dhe atyre me butan gaz në afërsi të ndërtesave të banimit.

Masat mbrojtëse:

- Mbyllja e të gjitha deponive ilegale të hekurit dhe automjeteve të vjetëruara,
- Hartimi i planeve të menaxhimit të rreziqeve dhe reagimit emergjent në rast të paraqitjes së zjarrit apo shpërthimeve të ndryshme.

9. MASAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT BAZUAR NË NDIKIMIN E HARTËS ZONALE

Masat e përgjithshme për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis janë paraqitur në vijim. Masat e paraqitura duhet të respektohen dhe implementohen plotësisht.

Masat për mbrojtjen e ajrit - Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, si dhe respektimi i ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Masat për mbrojtjen e tokës (dheut)- Mbrojtja e tokës është një aktivitet i interesit të përgjithshëm të shoqërisë i cili kryhet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Të zbatohen masat dhe rekomandimet që dalin nga Ligji për tokën bujqësore, i cili si qëllim kryesor ka krijimin e rregullativës ligjore për shfrytëzimin, mbrojtjen dhe rregullimin e tokës bujqësore.

Masat për mbrojtjen e tokës nga erozioni- Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontrolli i përmytjeve në zonën e erozionit ndërmerren masat kundër erozive si në vijim: ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm i lërimit të livadheve, kullotave dhe tokave të tjera bujqësore për shkak të konvertimit të tyre në tokë të punueshme me kulturat bujqësore vjetor, kultivimin e plantacioneve shumëvjeçare, përmirësimi i teknikave për trajtimin e tokës bujqësore, ngritjen dhe kultivimin e brezave mbrojtës bujqësor apo mbjelljen e bimëve drunore shumëvjeçare, ndalimi i kullotjes së bagëtive në një kohë të caktuar ose kufizimi i numrit të kafshëve që mund të lirohen në hapësira të caktuara, ndalimi i prerjes së pyjeve dhe plantacioneve pyjore mbi tokë të rrezikuar etj.

Masat për mbrojtjen e Ujit- Për menaxhimin më efikas të ujërave komuna e Malishevës duhet të koordinohet me aktivitetet, vendimet, masat dhe qëllimet e vendosura nga niveli qendror e sidomos nga Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Ujërave.

Masat për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore – Ruajtja e monumenteve të vjetra, si: ndërtesa religjioze, xhami e kisha, shtëpi të ndërtuara në mënyrë tradicionale si dhe objekte të tjera të vjetra si ura të cilat duhet të ruhen dhe konservohen për shkak të vlerave të tyre kulturore.

Masat për mbrojtjen e Resurseve Natyrore- Investime në infrastrukturë në përputhje me standarde dhe normat europiane, (ulëse, shtigje, lokacion për mbeturina, shenjëzim, ndriqim); çasje adekuate në monumente të natyrës; hartim i planeve menaxhuese në mënyrë që të nxisë

zhvillimin e turizmit; të rritet vetëdijësimi i qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit si dhe mirëmbajtja e zonave të mbrojtura, të pengohen dukuritë negative që rrezikojnë trashëgiminë natyrore.

Masat për mbrojtjen e Biodiversiteti- Ruajtja e florës dhe faunës, e sidomos specieve që gjenden në listën e kuqe të Kosovës. Rritja e vetëdijësimit të qytetarëve për rëndësinë e biodiversitetit dhe mbrojtjen nga faktori antropogjen.

Masat për mbrojtjen e Pyjeve - Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet nëpërmjet formave si në vijim:

Mbrojtja e tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve drunore dhe më pas përdorimi i kësaj toke për shfrytëzime të tjera jo-pyjore;

Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në formë të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale (nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës). Pjesët e djegura dhe të prera të pyjeve nga faktori antropogjen në vitet e fundit duhet ri-pyllëzuar.

Njoftimi dhe Siguria e Punëtorëve – Ofrimi i informatave tek popullsia lokale rreth fushëveprimit dhe kohës së fillimit dhe kohëzgjatjes së aktiviteteve të ndërtimit duke përgatitur njoftimin i cili duhet të vendoset në tabelën e njoftimeve Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Malishevës dhe në faqen e internetit të komunës dhe përmes mjeteve tjera të informimit si: radio dhe tv lokale, nëse është e nevojshme, për t'u siguruar se popullsia lokale është e informuar mirë;

- Inspektoratet lokale të ndërtimit dhe të mbrojtjessë mjedist/të natyrës duhet të jenë të informuara për punimet para fillimit;
- Të gjitha lejet/opinionet e nevojshme merren para fillimit të punimeve (duke përfshirë atë të ndërtimit, pëlqimet mjedisore, dhe të tjera);
- Të gjitha punët duhet të kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar;
- Rrobat dhe pajisjet mbrojtëse personale të punëtorëve duhet të jenë në dispozicion në sasi të mjaftueshme dhe vishen/përdoren gjatë gjithë kohës;
- Punëtorët duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe me përvojë adekuate për punën që kryejnë (p.sh. për punimet në lartësi);
- Gropat e hapura duhet të mbulohen dhe shënohen qartë kur nuk punohet në to;

- Të sigurohet shënimi përkatës dhe tabela informative e vendit të rindërtimit
- Shënimi i vendpunishteve për ruajtjen e përkohshme të materialit për rindërtim afër vendpunishtes
- Sigurimi i shiritave të paralajmërimit, rrethojave dhe shenjave përkatëse që paralajmërojnë rrezik, rregullat kyçe dhe procedurat që duhet të ndiqen
- Hyrja e ndaluar e personave të papunësuar brenda shiritave të paralajmërimit dhe rrethojave kur/ku shihet e nevojshme;
- Zona rrethuese afër sallës sportive duhet të mbahet e pastër;
- Makinat duhet të operohen vetëm nga personeli i trajnuar dhe me përvojë, duke zvogëluar kështu rrezikun e aksidenteve;
- Të gjithë punëtorët duhet të njihen me rreziqet e zjarrit dhe masat për mbrojtje nga zjarri dhe duhet të jenë të trajnuar për të operuar me fikësit e zjarrit, hidrantët dhe pajisjet tjera që përdoren për shuarjen e zjarrit
- Aparatet, pajisjet dhe fikësit e zjarrit duhet të jenë gjithmonë funksionale, kështu që në rast nevoje, mund të përdoren me shpejtësi dhe efikasitet. Kutitë e ndihmës së parë duhet të jenë në dispozicion në vendpunishte dhe personeli i trajnuar për ta përdorur.
- Procedurat për rastet e emergjencës (duke përfshirë derdhjet, aksidentet etj.) duhet të jenë në dispozicion në vendpunishte.
- Si pjesë e ndërtimit të çfarëdo rruge të re, ose ndërtese të re, duhet të kërkohet që të mbillen drunjtë përgjatë rrugëve. Një mesatare prej një druri për çdo 20 metra do të mbillen përgjatë gjatësisë së rrugës. Drunjtë e rrugëve mund të mos mbillen në intervale të caktuara, por mund të lëvizin për t'u përshtatur me infrastrukturën teknike, infrastrukturën publike, infrastrukturën sociale, rrugët publike dhe karakteristikat të tjera. Lokacionet për mbjelljen e drunjëve mund të jenë ose të mos jenë ndërmjet vijës rregulluese dhe skajit së rrugës, në varësi të rrethanave të vendit. Nëse drunjtë nuk janë të vendosur ndërmjet vijës rregulluese dhe skajit së rrugës, ato vendosen brenda parcelës menjëherë pranë vijës rregulluese, apo përgjatë vijës aksiale qarkulluese të rrugëve publike. Drunjtë të ri rrugorë nuk do të kërkohen aty ku ka drunjë ekzistues përgjatë rrugëve publike janë të shëndetshëm. Drunjtë e tillë do të ruhen dhe do të shërbejnë për të njëjtin qëllim.

- Të gjitha rregullimet e nevojshme të peizazhit mirëmbahen vazhdimisht nga pronari i pronës dhe mbahen të pastra nga mbeturinat. Çdo peizazh i kërkuar që vyshket, hiqet ose dëmtohet rëndë, duhet të zëvendësohet nga pronari aktual i pronës sa më shpejt që është praktike, duke pasur parasysh sezonet e rritjes, brenda një maksimumi prej 150 ditësh.
- Hapësirat e gjelbra, duhet të planifikohet në lokacione - në afërsi të zonave të banimit, në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE E VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) i Hartave Zonale të Komunë së Malishevës synon rritjen e mundësive mjedisore dhe minimizimin e ndikimeve dhe rreziqeve që lidhen me zbatimin e tyre. Qëllimi përfundimtar i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe kontribuimi në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Në Kosovë VSM-ja është e rregulluar me Ligjin Nr. 03/L- 230, i cili përcakton kushtet, formën dhe procedurat për aplikimin e VSM-së.

Fazat kyçe të raportit të VSM-së, dhe rezultatet e tyre, janë si në vijim:

- Baza ligjore e legjislacionit të Kosovës që përcakton objektivat dhe politikat e mbrojtjes së mjedisit që janë potencialisht relevante për HZK-në;
- Janë prezantuar një përmbledhje e konventave ndërkombëtare mjedisore, relevante për HZK-në;
- Me theks të veçantë gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë në shqyrtim Konventa Aarhus, Espoo dhe Protokolli i Kievit;
- Procesi dhe metodologjia e VSM-së dhe fazat kyçe të procesit të VSM-së;
- Të dhënat e përgjithshme për Komunën e Malishevës, pozita gjeografike dhe ndarja administrative;
- Gjendja aktuale mjedisore në Komunën e Malishevës;
- Identifikimi i veprimeve strategjike në mjedis të Hartave Zonale të Komunë së e Malishevës;
- Është prezantuar një përmbledhje e ndikimeve mjedisore për secilen zonë veç e veç, dhe janë përshkruar masat për mbrojtjen e mjedisit;
- Janë përshkruar masat e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit për secilën zonë të HZK-së;
- Janë dhënë rekomandimet e nevojshme për secilën zonë, dhe rekomandimet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit nga implementimi i HZK-së;
- Literatura dhe burime të informacionit;

PËRFUNDIM

Hartimi i HZK-së është një proces i plotë i planifikimit të territorit për komunën e Malishevës. Bazuar në studimin e bërë për Vlerësimin Strategjik Mjedisor ndikimet e mundshme, masat për parandalimin e ndikimeve të Hartave Zonale të Komunës së Malishevës, si dhe duke i'u referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludohet si në vijim:

Vlerësimi Strategjik Mjedisor për HZK-në do të ketë një ndikim pozitiv nëse zbatohen rekomandimet nga ky raport. HZK-ja do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes ekonomike, sociale dhe atë mjedisore. VSM do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribuojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rrethë vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e pëlleshme bujqësore për rrethë.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatimit të HZK-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore. Përmes HZK-së krijohet mundësia e qartësimit dhe detajimit më të hollësishëm gjatë hartimit të planeve dhe projekteve tjera lokale. Zbatimi praktik i parimeve të përgjithshme në rastin e HZK-së nxjerr disa përparësi si psh. Zhvillimi kompakt i vendbanimeve, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë historike, ruajtja e peizazhit natyror, ruajtja e llojllojshmërisë së biodiversitetit, ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme..

Gjatë VSM për hartën zonale komunale një segment me rëndësi është përfshirë edhe Ujëvara e Mirushës si dhe llojet e mbrojtura të deklaruara në bazë të Librit të kuq i faunës së Kosovës, dhe Përveq Ujëvarës së Mirushës, duhet përfshirë edhe 4 monumente natyrore me karakter hidrografik si: Burimi termal në Banjë, Burimi Gurbardh, Burimi i ujit në Caravranë dhe Rrjedha e lumit Mirusha.

Harta Zonale për Komunën e Malishevës përpiket të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuar gjerësisht përfshirë:

- Komunë me vendbanime të sigurt.
- Komunë e shëndetshme dhe pa mbeturina.

- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe atyre pyjore duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe krijimin e korridoreve ekologjike në dhe përreth vendbanimeve.
- Përmirësime dhe zgjerimi i rrugëve përfshirë edhe korsitë për biçikleta dhe këmbësorët
- Përmirësim i transportit publik (përmirësim i shërbimit të autobusëve).
- Zgjerim i vendbanimeve në drejtimin e tokës më pak kualitative bujqësore.
- Përfshirja dhe integrimi në planifikim i situatës faktike të ndërtimeve dhe tipologjisë së përdorimit të tokës.

Këto objektiva na ndihmojnë që të kemi një jetesë më cilësore me vendbanime të shëndetshme dhe të sigurta, shtimin e aktiviteteve, shtimi i parqeve dhe zonave të gjelbëruara, cilësi me të mirë të ajrit, ujit dhe tokës.

Me hartimin dhe hyrjen në fuqi të HZK-së arrihet një hap cilësor në planifikimin e qëndrueshëm të territorit, burime natyrore si turizmi, peisazhi, biodiversiteti dhe objektet tjera speleologjike e gjeomonumentet që e karakterizojnë komunën e Malishevës.

Por nuk mjaftojnë vetëm raporte dhe plane zhvillimore. Andaj si shoqëri duhet të punojmë vazhdimisht me ndihmën e institucioneve dhe qytetarëve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kontrollit mjedisor. Ngritja e mekanizmave të tillë në nivel komunal do të ishte një hap i parë në drejtimin e duhur për përmirësimin e gjendjes së Komunës dhe një të ardhme më cilësore.

LITERATURA

- Ligji i Kosovës për Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) nr.03/L-230
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) nr.03/L-214
- Ligji për Mbrojtjen e Ujërave nr. 04/L-147
- Harta Zonale e Komunës së Malishevës
- Plani Zhvillimor Komunal – Malishevë 2019-2027
- Analiza Hapësinore – Malishevë 2008
- Raporti për Gjendjen e Natyrës 2015-2017
- Raporti I zhvillimit Hapësinor për sektorin e turizmit – 2004
- Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020
- Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022
- Plani Hapësinor, Zona e Interesit të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Kleçkë dhe Divjakë”
- Plani Hapësinor “Monumenti i Natyrës me Rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës” 2012
- Vlerësimi Popullsia e Kosovës- ASK 2020
- Zonat e Mbrojtura, AMMK. 2016
- Biodiversiteti i Kosovës- AMMK
- Flora Vaskulare Endemike e Kosovës
- Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës- 2013
- Libri i Kuq i Faunës të Republikës së Kosovës- 2019
- Raport- Kadastri I Ndotësve të Ujërave të Kosovës
- Raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë, AMMK
- Strategjia për zhvillimin e pylltarisë 2010-2020
- Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë